



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 131

Tiranë – E mërkurë, 23 korrik 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 42/2025, datë 26.6.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017, “Për sportin”, i ndryshuar..... 19203
Dekret i Presidentit nr. 252, datë 21.7.2025	Për shpallje ligji..... 19205
Ligj nr. 54/2025, datë 3.7.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... 19206
Dekret i Presidentit nr. 253, datë 21.7.2025	Për shpallje ligji..... 19209
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 16.7.2025	Për dhënien në përdorim të shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., të pronës nr. 173, me emërtimin “Ish-grupdepo të industrisë”, dhe të pronës nr. 174, me emërtimin “Ish-sh.a. Autoreparti”, me vendndodhje në zonën kadastrale 1066, Babru, Tiranë..... 19209
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 849, datë 18.7.2025	Për delegim kompetence..... 19209
Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 6, datë 16.7.2025	Për miratimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative..... 19210
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 433, datë 22.7.2025	Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve..... 19238

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Deda.....	19240
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Mehmet Bici.....	19240



LIGJ
Nr. 42/2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 79/2017,
“PËR SPORTIN”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 79/2017, “Për sportin”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. “Fondacionet në fushën e sportit” janë organizata jofitimprurëse të themeluara nga institucionet publike, persona juridikë dhe fizikë, që administrojnë apo ushtrojnë veprimtari sportive. Fondacionet në fushën e sportit, të themeluara nga institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, mund të financohen nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.”.

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. “Këshilli i Arbitrazhit Sportiv” është organizatë e pavarur jofitimprurëse, që krijohet në formën e qendrës, e cila drejton, autorizon, mbikëqyr, kontrollon dhe vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin nëpërmjet trupave të gjyqimit të mosmarrëveshjeve.”.

3. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“12. “Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen paralimpike në Shqipëri.”.

4. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

“13/1. “Lëvizja paralimpike” është organizim universal dhe i përhershëm për individët me aftësi fizike të kufizuara dhe subjektet, që janë frymëzuar

nga vlerat e olimpizmit në të pesta kontinentet e që kryhet nën autoritetin e Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar.”.

5. Pika 16 ndryshohet si më poshtë:

“16. “Organizatë sportive” është Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, federatat sportive, Olimpiku Special Shqiptar, klubet sportive, shoqëritë sportive dhe shoqatat sportive dhe fondacionet në fushën e sportit, të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.”.

6. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1 me këtë përmbajtje:

“17/1. “Olimpiku Special Shqiptar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpike speciale për personat me aftësi intelektuale të kufizuara në Shqipëri.”.

Neni 2

Në nenin 6 pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Aktivitetet sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe në institucionet e arsimit të lartë organizohen jashtë procesit mësimor edhe nga institucionet shtetërore dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar me projekte për zhvillimin e sportit.”.

Neni 3

Në nenin 11 shtohen shkronjat “a/1”, “a/2” dhe “c/1” me këtë përmbajtje:

“a/1. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar;

a/2. fondacionet në fushën e sportit;

...

c/1. Olimpiku Special Shqiptar.”.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Financimi i organizatave sportive dhe i aktiviteteve sportive ndërkombëtare

1. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, Olimpiku Special Shqiptar, federatat sportive, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv dhe fondacionet sportive me



themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transferte, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, federatat sportive olimpike, fondacionet sportive me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit dhe Këshilli i Arbitrazhit Sportiv financohen nga buxheti i shtetit në formë transferte. Kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së grantit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ministria përgjegjëse për sportin financon Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Olimpikun Special Shqiptar, federatat joolimpike dhe fondacionet sportive me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, me projekte nga buxheti i saj në formë transferte për veprimtari të propozuara prej tyre. Kriteret, procedurat e aplikimit dhe të shqyrtimit, mënyra e përzgjedhjes së projekteve dhe procedura e financimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Aktivitetet sportive me karakter ndërkombëtar me impakt social, kulturor, ekonomik dhe turistik në vend, në rastet kur vendoset të zhvillohen në Republikën e Shqipërisë me propozimin e ministrisë përgjegjëse për sportin, financohen sipas procedurave dhe kriterëve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministria përgjegjëse për sportin monitoron e kontrollon në mënyrë periodike, sipas legjislacionit buxhetor, veprimtarinë dhe administrimin e transfertës së buxhetit të shtetit në të gjitha organizatat sportive, që kanë përfituar nga fondet publike.”.

Neni 5

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

**Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar
dhe Olimpiku Special Shqiptar**

1. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar janë persona juridikë, që organizohen dhe funksionojnë në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor

për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpikë dhe statutin e tij të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente.

2. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Paralimpikë Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, mbështetet në parimet e sistemit ndërkombëtar të sporteve paralimpikë dhe në rezolutat e udhëzimet e nxjerra nga Komiteti Paralimpik Ndërkombëtar.

3. Olimpiku Special Shqiptar është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpikë Speciale Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me marrëveshjen e licencës së akreditimit të Olimpikut Special Botëror “Special Olympics”.

4. Statuti dhe ndryshimet statutores të Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpikut Special Shqiptar miratohen nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit. Pas kalimit të këtij afati, statuti dhe ndryshimet statutores konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, statuti dhe ndryshimet statutores regjistrohen në gjykatë.

5. Ministria përgjegjëse për sportin njih vetëm një Komitet Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe vetëm një Olimpik Special Shqiptar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e tyre.

6. Në Komitetin Paralimpik Kombëtar Shqiptar aderojnë federatat shqiptare, shoqata, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë, që në statut kanë të përfshirë veprimtari për persona me aftësi fizike të kufizuara, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij komiteti.

7. Në Olimpikun Special Shqiptar mund të aderojnë federatat shqiptare, ku kanë të përfshirë olimpikun special dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë e fizikë, të cilët plotësojnë dhe pranojnë kushtet e përcaktuara në statutin e tij.”.

Neni 6

Pika 2 e nenit 24 ndryshohet si më poshtë:



“2. “Këshilli i Arbitrazhit Sportiv” është organizatë e pavarur jofitimprurëse, që krijohet në formën e qendrës, e cila drejton, autorizon, mbikëqyr, kontrollon dhe vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin nëpërmjet trupave të gjyqimit të mosmarrëveshjeve.”.

Neni 7

Në nenin 42 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Lojërat olimpike speciale dhe veprimtaritë me karakter olimpike special organizohen nga Olimpiku Special Shqiptar.

1/2. Lojërat Paralimpike dhe veprimtaritë me karakter paralimpik organizohen nga Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar.”.

2. Në pikën 3 pas fjalëve “Për organizimin e lojërave olimpike” shtohen fjalët “olimpike speciale dhe paralimpike “.

Neni 8

Në pikën 5 të nenit 44 pas fjalëve “sipas Konventës Evropiane Antidoping” shtohen fjalët “dhe Agjencisë Botërore Antidoping”.

Neni 9

Pas nenit 58 shtohet neni 58/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 58/1

Financimi i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, i Komitetit Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe i Olimpikut Special Shqiptar

1. Olimpiku Special Shqiptar realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon 9 (nëntë) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon 24 (njëzet e katër) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar realizon ushtrimin e plotë të funksioneve dhe të kompetencave me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit fillon 24 (njëzet e katër) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

Neni 10

Akte nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 të këtij ligji miratohen brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 252, datë 21.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 252, datë 21.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 42/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017, ‘Për sportin’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 54/2025

Neni 3

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 64/2014, “PËR
PUSHTETET DHE AUTORITETET E
DREJTIMIT E TË KOMANDIMIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 169, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 12 të nenit 6 shtohen pikat 12/1 dhe 12/2 me këtë përmbajtje:

“12/1. “Plani i vendosjes dhe përhapjes i Forcave të Armatosura” është plani me karakter strategjik, në të cilin përcaktohen vendndodhja e zonave dhe objekteve, ku kryejnë aktivitetin e tyre ditor për punë, jetesë, stërvitje, përgatitje për operacione, përkujdesje, si dhe marrin mbështetje logjistike dhe administrative Forcat e Armatosura në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

12/2. “Pronat jashtë planit të vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura” janë ato pasuri të paluajtshme shtetërore, që janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes ose të një personi tjetër juridik, të krijuar sipas formave të parashikuara nga ligji, pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe që nuk janë pjesë të planit të vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura.”

Neni 2

Në titullin e nenit 7 fjala “strategjik” zëvendësohet me fjalët “të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Pas shkronjës “i” të nenit 11 shtohet shkronja “j” me këtë përmbajtje:

“j) përcakton rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të tjera shtetërore në angazhimin e strukturave, mjeteve dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 4

Në nenin 13 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “h” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“h) emëron, liron ose shkarkon nga detyra oficerët aktivë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe oficerët me gradën “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë” dhe “kolonel/kapiten i rangut të parë” në Forcat e Armatosura, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me përjashtim të oficerëve me grada madhore;”.

2. Pas shkronjës “h” të pikës 2 shtohet shkronja “h/1” me këtë përmbajtje:

“h/1) nxjerr në rezervë apo në lirim oficerët aktivë të Forcave të Armatosura, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me përjashtim të oficerëve me grada madhore;”.

3. Shkronja “j” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“j) komandon në një detyrë tjetër oficerët aktivë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe oficerët me gradën “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë” dhe “kolonel/kapiten i rangut të parë”, në Forcat e Armatosura, për një periudhë kohe jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, me të drejtë rikomandimi, por jo më shumë se 2 (dy) herë, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me përjashtim të oficerëve me grada madhore;”.

4. Pas shkronjës “sh” të pikës 2 shtohet shkronja “t” me këtë përmbajtje:

“t) i propozon për miratim Presidentit të Republikës planin e vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura.”



5. Pika 4 e nenit 13 ndryshohet si më poshtë:

“4. Ministri i Mbrojtjes zëvendësohet nga zëvendësministri i Mbrojtjes në kryerjen e detyrave, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 5

Në nenin 15 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “m” të pikës 9 shtohet shkronja “m/1” me këtë përmbajtje:

“m/1) emëron, liron ose shkarkon nga detyra oficerët aktivë të Forcave të Armatosura me gradën “nëntoger/nënlejtënant”, “toger/lejtënant”, “kapiten/kapitenlejtënant” dhe “major/kapiten i rangut të tretë”, me propozimin e komandantëve të Forcave të Armatosura, të strukturave mbështetëse dhe të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm, me përjashtim të personelit oficer të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes;”.

2. Pas shkronjës “n” të pikës 9 shtohet shkronja “n/1” me këtë përmbajtje:

“n/1) miraton marrjen në punë me kontratë për personelin civil në funksionet ushtar/civil (U/C) dhe nënoficer/civil (N/C) të strukturave të Forcave të Armatosura, me propozimin e komandantëve të Forcave, të strukturave mbështetëse dhe të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm, me përjashtim të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil ose që janë në funksione oficer/civil (O/C);”.

3. Pas shkronjës “p” të pikës 9 shtohet shkronja “p/1” me këtë përmbajtje:

“p/1) komandon në një detyrë tjetër oficerët aktivë të Forcave të Armatosura me gradën “nëntoger/nënlejtënant”, “toger/lejtënant”, “kapiten/kapitenlejtënant” dhe “major/kapiten i rangut të tretë”, për një periudhë kohe jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, me të drejtë rikomandimi, por jo më shumë se 2 (dy) herë, përjashtuar personelin oficer të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes;”.

4. Shkronja “q” e pikës 9 ndryshohet si më poshtë:

“q) komandon në një detyrë tjetër ushtarët aktivë, nënoficerët dhe personelin civil, me përjashtim të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit

civil, të atyre që janë në funksione oficer/civil (O/C) në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë dhe nga një forcë, strukturë mbështetëse në një tjetër, për një periudhë kohe jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, me të drejtë rikomandimi, por jo më shumë se 2 (dy) herë, me propozimin e komandantëve të Forcave, të strukturave mbështetëse dhe të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;”.

5. Shkronja “r” e pikës 9 ndryshohet si më poshtë:

“r) miraton kalimin në emërtesë të personelit nënoficer, ushtar dhe të personelit civil, me përjashtim të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ose që janë në funksione oficer/civil (O/C), në Forcat e Armatosura, me propozimin e komandantëve të Forcave, strukturave mbështetëse dhe të strukturave të varësisë së drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;”.

6. Pika 11 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

“11. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura zëvendësohet nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në kryerjen e detyrave, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 6

Në nenin 18 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën “ç” të pikës 5 të nenit 18 në fund të fjalës, pas fjalës “oficeri” shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “si dhe merr në punë me kontratë, me miratimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, personelin civil, i cili është në funksione ushtar/civil (U/C), nënoficer/civil (N/C).”.

2. Pas shkronjës “ç” të pikës 5 të nenit 18 shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) komandon në një detyrë tjetër nënoficerët aktivë, ushtarët aktivë dhe personelin civil të forcës apo të strukturës mbështetëse që drejton, me përjashtim të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil ose që janë në funksione oficer/civil (O/C), për një periudhë kohe jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) herë.”.

Neni 7

Pas kreut III shtohet kreu III/1 me këtë përmbajtje:



“KREU III/1

**KOMPETENCAT PËR HARTIMIN DHE
RISHIKIMIN E PLANIT TË VENDOSJES
DHE PËRHAPJES DHE ADMINISTRIMI I
PRONAVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Neni 23/1

Hartimi i planit të vendosjes dhe përhapjes

1. Plani i vendosjes dhe përhapjes i Forcave të Armatosura hartohet nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, bazuar në planin afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura.

2. Plani i vendosjes dhe përhapjes i Forcave të Armatosura përmban detyrime të emërimit dhe vendndodhjen e strukturës, si dhe koordinatat.

3. Procedurat për hartimin dhe rishikimin e planit të vendosjes dhe përhapjes, si dhe modeli i tij, miratohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 23/2

**Kriteret e rishikimit të planit të vendosjes
dhe përhapjes**

1. Plani i vendosjes dhe përhapjes i Forcave të Armatosura rishikohet periodikisht çdo 5 (pesë) vjet dhe në çdo kohë në rastet e:

a) ndryshimeve të nevojave të Forcave të Armatosura;

b) përputhshmërisë me nevojat operationale për mbështetjen e operationeve dhe të plotësimit të standardeve të NATO-s;

c) investimeve me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit apo ndërtimeve, përmirësimeve të infrastrukturës publike, që prekin pjesërisht apo plotësisht një pronë brenda planit të vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura, kur vlerësohet se ky ndryshim nuk cenon operationalitetin e Forcave të Armatosura.

2. Për qëllime të shkronjës “c” të pikës 1, të këtij neni, institucioni përgjegjës për investimet e rëndësisë së veçantë kërkon rishikimin e planit të vendosjes dhe përhapjes, pasi vlerëson natyrën dhe rëndësinë e investimit.

3. Në çdo rast, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura garanton gatishmërinë operationale të Forcave të Armatosura.

Neni 23/3

Administrimi i pronave

1. Pronat në përgjegjësi administrimi administrohen nga Ministria e Mbrojtjes ose nga një person tjetër juridik, i krijuar sipas formave të parashikuara nga ligji, pranë Ministrisë së Mbrojtjes për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Pronat brenda dhe jashtë planit të vendosjes dhe përhapjes mund të jepen për përdorim të dyfishtë, në interes të Ministrisë së Mbrojtjes, për at kohë sa nuk cenohen kapacitetet operationale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Në kuptim të pikës 2 të këtij neni, termi i përdorimit të dyfishtë nga Ministria e Mbrojtjes nënkupton mundësinë për të administruar pronën shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, si në funksion të garantimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura, ashtu edhe në funksion të zhvillimit dhe rritjes së vlerës ekonomike të saj.

4. Kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me qira, enfiteozë, përdorim të dyfishtë apo forma të tjera përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri i Mbrojtjes për nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 3 dhe 7 të këtij ligji brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.7.2025.

**Shpallur me dekreten nr. 253, datë 21.7.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

**DEKRET****Nr. 253, datë 21.7.2025****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 54/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2014, Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM**Nr. 410, datë 16.7.2025**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TE
SHOQËRIA SHTETËRORE “KAYO” SHA,
TË PRONËS NR. 173, ME EMËRTIMIN
“ISH-GRUPDEPO TË INDUSTRIKË”,
DHE TË PRONËS NR. 174, ME
EMËRTIMIN “ISH-SHA AUTOREPARTI”,
ME VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 1066, BABRU, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim te shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., të pronës nr. 173, me emërtimin “Ish-grupdepo të industrisë”, dhe të pronës nr. 174, me emërtimin “Ish-sh.a. Autoreparti”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes (Komandës Mbështetëse), me vendndodhje në zonën kadastrale 1066, Babru, Tiranë, me qëllim përdorimin sipas

objektit të veprimtarisë së shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a.

2. Shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a., i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit përtej objektit të saj të veprimtarisë, të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi ose t'i tjetërsojë pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR**Nr. 849, datë 18.7.2025****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të gremës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, germa “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Igli Lubonja, drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Menaxhimit të Sistemeve për sa vijon:

- Për të trajtuar dhe nënshkruar shkresat me karakter njohës dhe informues dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë të Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Menaxhimit të Sistemeve, që u përcillen drejtorive vendore të ASHK-së për trajtim e informim dhe që kanë të bëjnë me kërkesat për informacion që dërgohen nga institucione, si: Prokuroria, Gjykata, Tatime, Përmbarues Gjyqësorë, Policia, ILDKPI-ja, AZHT-ja, AIF-i, KPA-ja, Dogana.

- Sa më sipër, bëjnë përjashtim shkresat që u drejtohen presidentit të Republikës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrave, Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministritë/ministrive, Avokatit të Popullit, Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, Agjencisë



Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të cilat janë kompetencë e drejtorit të përgjithshëm dhe nënshkruhen prej tij.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Menaxhimit të Sistemeve nëse e vlerëson të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat të cilat përbëjnë një rëndësi të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin çështjet që kanë një rëndësi të veçantë, aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”. Shkresat që trajtojnë problematika, mosmarrëveshje administrative apo civile që kërkojnë nxjerrjen e akteve administrative/kryerjen e veprimeve administrative nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Menaxhimit të Sistemeve, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Menaxhimit të Sistemeve dhe drejtori i tyre, z. Igli Lubonja, dhe Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I AGJENCISË SHITËTËRORE
TË KADASTRËS
Lorena Goxhobelli

UDHËZIM

Nr. 6, datë 16.7.2025

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRLLOGARITJEN E MASËS SË SANKSIONEVE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 94, si dhe pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

1. Përcaktimin e masës së sanksioneve administrative të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 94 të ligjit, të bazuar në një vlerësim specifik të kryer rast pas rasti sipas tekstit të “Metodologjisë për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Zbatimin e kësaj metodologjie, për të mundësuar një aplikim të drejtë, transparent dhe proporcional të përllogaritjes së vlerës së masës së sanksionit administrativ.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Besnik Dervishi

METODOLOGJI PËR PËRLLOGARITJEN E MASËS SË SANKSIONEVE ADMINISTRATIVE

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive

KAPITULLI 1. HYRJE

1.1 Qëllimi

KAPITULLI 2. METODOLOGJIA E PËR- LLOGARITJES SË MASËS SË SANKSIONIT ADMINISTRATIV

2.1 Informacion i përgjithshëm

2.2 Pasqyrë e sintetizuar e metodologjisë



2.3 Shkelje të sanksionueshme me masa fikse

KAPITULLI 3. SHKELJE KONKURRUESE DHE ZBATIMI I NENIT 93(3) TË LIGJIT

3.1 Një sjellje e sanksionueshme

3.1.1 Konkurrenca e shkeljeve

Parimi i specialitetit

Parimi i subsidiaritetit

Parimi i konsumit

3.1.2 Uniteti i veprimit – neni 93(3) i ligjit

3.2 Shumësia e veprimeve të sanksionueshme

KAPITULLI 4. PIKËNISJA E PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SANKSIONIT ADMINISTRATIV

4.1 Kategorizimi i shkeljeve sipas nenit 94 të ligjit

4.2 Shkalla e rëndësisë së shkeljes sipas rrethanave në çdo rast individual

4.2.1 Natyra, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes

4.2.2 Karakteri i qëllimshëm (dashja) ose pakujdesia

4.2.3 Kategoritë e të dhënave personale të prekura

4.2.4 Klasifikimi i rëndësisë së shkeljes dhe identifikimi i shumës së pikënisjes së përllogaritjes së sanksionit administrativ

4.3 Xhiroja e ndërmarrjes si element për vendosjen e një sanksioni efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues

KAPITULLI 5. RRETHANAT RËNDUESE DHE LEHTËSUESE

5.1 Identifikimi i faktorëve rëndues dhe lehtësues

5.2 Veprimet e kontrolluesit/përpunuesit në zbutjen e dëmit të pësuar nga subjektet e të dhënave

5.3 Shkalla e përgjegjësisë së kontrolluesit/përpunuesit

5.4 Shkeljet e mëparshme të kontrolluesit/përpunuesit

5.4.1 Korniza kohore

5.4.2 Çështja

5.4.3 Vlerësime të tjera

5.5 Shkalla e bashkëpunimit me Zyrën e Komisionerit për korrigjimin e shkeljes dhe zbutjen e efekteve negative të saj

5.6 Mënyra sesi shkelja i është bërë e ditur Zyrës së Komisionerit

5.7 Përputhshmëria me detyrat e lëna më herët për të njëjtën çështje

5.8 Respektimi i kodeve të miratuara të sjelljes dhe/ose mekanizmave të miratuar të certifikimit

5.9 Rrethana të tjera rënduese dhe lehtësuese

KAPITULLI 6. TAVANI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSIA KORPORATIVE

6.1 Përcaktimi i tavanit ligjor

6.1.1 Tavanet ligjore statike

6.1.2 Tavanet ligjore dinamike

6.2 Përcaktimi i xhiros së ndërmarrjes dhe përgjegjësia korporative

6.2.1 Përcaktimi i një ndërmarrjeje dhe përgjegjësia korporative

6.2.2 Përcaktimi i xhiros

KAPITULLI 7. EFEKTIVITETI, PROPORCIONALITETI DHE KARAKTERI PARANDALUES

7.1 Efektiviteti

7.2 Proporcionaliteti

7.3 Karakteri parandalues

KAPITULLI 8. FLEKSIBILITETI DHE VLERËSIMI I RREGULLT

Përmbledhje ekzekutive

Kjo metodologji për llogaritjen e sanksioneve administrative, e miratuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), përbën një instrument detyrues për Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale pranë Zyrës së Komisionerit, për vlerësimin e drejtë, transparent dhe korrekt të masës së sanksionit administrativ ndaj një kontrolluesi/përpunuesi të caktuar – shkelës të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale – siç përcaktohet në nenin 94, në harmoni me nenin 93, të ligjit nr. 124, datë 19.12.2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “ligji për mbrojtjen e të dhënave”).

Për t’i ardhur në ndihmë një vlerësimi brenda parametrave të parashikuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave, Zyra e Komisionerit ka miratuar këtë metodologji, e cila përbëhet nga pesë hapa, për llogaritjen e sanksioneve administrative për shkeljet e dispozitave të tij.

Së pari, duhet të identifikohet veprimtaria përkatëse e përpunimit të të dhënave dhe vlerësohet zbatueshmëria e dispozitave të pikës 3 të nenit 93 (që trajtohet në kapitullin 3, të kësaj metodologjie).

Së dyti, duhet të identifikohet pikënisja e përllogaritjes së masës së sanksionit administrativ (kapitulli 4). Kjo kryhet duke vlerësuar klasifikimin e shkeljes sipas dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, duke vlerësuar shkallën e rëndësisë së



shkeljes në dritën e rrethanave të rastit, si dhe duke vlerësuar xhiron e sipërmarrjes/shoqërisë tregtare/organizatës jofitimprurëse sipas formës ligjore të kontrolluesit/përpunuesit (në vijim “Kontrollues/përpunues”).

Së treti, duhen vlerësuar rrethanat rënduese dhe/ose lehtësuese që lidhen me sjelljen e mëparshme ose aktuale të kontrolluesit/përpunuesit, me qëllim zmadhimin ose zvogëlimin e masës së sanksionit, në përputhje me rrethanat përkatëse (kapitulli 5).

Së katërti, duhen identifikuar tavanet ligjore të masës së sanksionit përkatës, për shkelje të ndryshme. Zmadhimet e aplikuara në hapat e mëparshëm ose të ardhshëm nuk mund të kalojnë këtë tavan ligjor, siç përcaktohet, përkatësisht, në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave (kapitulli 6).

Së pesti, duhet të analizohet nëse masa përfundimtare e sanksionit të përlogaritur i plotëson kërkesat e efektivitetit, proporcionalitetit dhe karakterit parandalues të saj. Në çdo rast masa përkatëse e sanksionit mund të jetë subjekt rishikimi në përputhje me rrethanat e rastit (kapitulli 7), pa tejkaluar në çdo rast tavanet ligjore për përcaktimin e masës së sanksionit.

Përgjatë gjithë hapave të sipërpërmendur, duhet pasur parasysh se përlogaritja e masës së sanksionit nuk është thjesht një ushtrim matematikor. Përkundrazi, rrethanat e rastit specifik janë faktorët vendimtarë që përcaktojnë vlerën përfundimtare të sanksionit, që – në të gjitha rastet – mund të ndryshojë midis vlerës minimale dhe maksimale ligjore.

KAPITULLI 1 HYRJE

1.1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj metodologjie është krijimi i pikënisjeve të përlogaritjes së masës së sanksionit, si një orientim, mbi bazën e të cilave të mund të kryhet përlogaritja në praktikë e sanksioneve për çdo rast specifik. Megjithatë, bazuar edhe në jurisprudencën e BE-së, kjo metodologji nuk mund të jetë aq

specifike sa t'i mundësojë një kontrolluesi ose përpunuesi të caktuar të bëjë përlogaritje paraprake, të saktë, matematikore të sanksionit të pritshëm¹. Në të gjithë këtë dokument theksohet se masa përfundimtare e sanksionit varet nga të gjitha rrethanat e çështjes specifike, të cilat do të vlerësohen rast pas rasti. Prandaj, Zyra e Komisionerit synon një qasje harmonizuese sa i takon ekzistencës së një modeli të ndjekur për përlogaritjen e masës së sanksionit, në vend të harmonizimit të rezultatit të përlogaritjes.

2. Pavarësisht nga kjo metodologji, Zyra e Komisionerit mbeten subjekt i të gjitha detyrimeve procedurale sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, për arsyetimin e vendimmarrjeve të dhëna, në kuadër ushtrimit të veprimtarisë së saj mbikëqyrëse/inspektuese. Në këtë aspekt, megjithëse Zyra e Komisionerit duhet të paraqesë argumente dhe arsye të mjaftueshme ligjore për konstatimet dhe gjetjet e saj, gjatë veprimtarisë mbikëqyrëse/inspektuese, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi, kjo metodologji nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet si një model shterues, preciz dhe detyrues për Zyrën e Komisionerit për përlogaritjen e masës së sanksionit ose për të paracaktuar ndikimin konkret të çdo rrethane rënduese ose lehtësuese² të rastit. Më tej, thjeshtë referenca në këtë metodologji nuk mund të zëvendësojë arsyetimin që duhet dhënë në një çështje specifike, në përputhje me legjislacionin procedural dhe material në fuqi.

3. Kjo metodologji do të jetë objekt rishikimi i vazhdueshëm, bazuar në praktikën e zbatimit të Rregullores së BE-së në vendet e BE-së, si dhe bazuar në praktikën administrative të Zyrës së Komisionerit.

KAPITULLI 2 METODOLOGJIA E PËRLOGARITJES SË MASËS SË SANKSIONIT ADMINISTRATIV

2.1 Informacion i përgjithshëm

4. Përlogaritja e masës së sanksionit administrativ është në diskrecionin e Zyrës së Komisionerit si autoriteti mbikëqyrës i ngarkuar me

¹ Shiko, për shembull, çështjen C-189/02 P, C-202/02 P, C-205/02 P to C208/02 P and C-213/02 P, *Dansk Rørindustri A/S dhe të tjerët kundër Komisionit*, paragrafi. 172 dhe çështjen T-91/11, *InnoLux Corp. kundër Komisionit*, paragrafi 88.

² Ky është qëndrim *in expressi verbis* i Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave, në udhëzuesin e miratuar nga ky Bord në lidhje me përlogaritjen e sanksioneve administrative.



ligj për këtë qëllim. Dispozitat dhe fryma e përgjithshme e ligjit për mbrojtjen e të dhënave, kërkojnë që shumica e sanksionit në çdo rast individual të jetë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues (neni 93(1) i ligjit). Për më tepër, gjatë përcaktimit të masës së sanksionit, duhet t'i kushtohet vëmendje listës së rrethanave që i referohen veçorive të shkeljes (shkallës së rëndësisë së saj) ose sjelljes së shkelësit (neni 93(2) i ligjit). Prandaj, përcaktimi sasi i masës së sanksionit bazohet në një vlerësim specifik të kryer në çdo rast, duke marrë parasysh parametrat e përfshirë në dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

5. Për sjellje që shkelin rregullat e mbrojtjes së të dhënave, në dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave nuk parashikohet një masë minimale sanksioni. Përkundrazi, në to parashikohen vetëm tavanet maksimale, sipas nenit 94 të ligjit, në të cilin grupohen së bashku disa lloje të ndryshme sjelljesh. Një sanksion mund të përlogaritet, në mënyrë përfundimtare, vetëm duke vlerësuar dhe peshuar të gjithë elementet e identifikuar shprehimisht në pikën 2, të nenit 93 të ligjit, të cilat lidhen me çështjen përkatëse, si dhe çdo element tjetër përkatës, pavarësisht nëse përmendet ose jo shprehimisht në dispozitat në fjalë (pasi germa “gj” e pikës 2 të nenit 93 të ligjit kërkon që t'i kushtohet vëmendje e duhur çdo faktori tjetër të zbatueshëm). Së fundi, masa përfundimtare e sanksionit që rezulton nga ky vlerësim duhet të jetë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues, për secilin rast specifik (pika 1 e nenit 93 të ligjit). Çdo sanksion i vendosur duhet të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e parashikuara në këtë dispozitë, por pa tejkaluar në të njëjtën kohë tavanin ligjor të masës së sanksionit, të parashikuar në nenin 94, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

2.2 Pasqyrë e sintetizuar e metodologjisë

6. Duke marrë parasysh këta parametra, Zyra e Komisionerit ka hartuar këtë metodologji, për përlogaritjen e masave të sanksioneve administrative, për shkeljet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

Hapi 1:

Identifikimi i proceseve/veprimtarisë së përpunimit, sipas rastit konkret dhe vlerësimi i zbatimit të pikës 3 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave (kapitulli 3).

Hapi 2:

Përcaktimi i modelit për përlogaritjen e mëtejshme të sanksionit, bazuar në një vlerësim të (kapitulli 4):

a) klasifikimit të shkeljes, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 94, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave;

b) seriozitetit të shkeljes, sipas germave “a”, “b” dhe “e” të pikës 2, të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave;

c) xhiros së ndërmarrjes, si një element i rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë, me synim vendosjen e një sanksioni efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues, sipas pikës 1, të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

Hapi 3:

Vlerësimi i rrethanave rënduese dhe lehtësuese që lidhen me sjelljen e mëparshme ose të tanishme të kontrolluesit/përpunuesit si dhe zmadhimi ose zvogëlimi i masës së sanksionit, në përputhje me këto rrethana (kapitulli 5).

Hapi 4:

Identifikimi i tavanit ligjor, për masën e sanksionit lidhur me proceset/veprimtaritë e ndryshme të përpunimit. Zmadhimet e aplikuara ose që do të aplikohen nuk mund të tejkalojnë këtë tavan (kapitulli 6).

Hapi 5:

Kryerja e analizës nëse shumica përfundimtare e sanksionit të përlogaritur plotëson kërkesat e efektivitetit, proporcionalitetit dhe karakterit parandalues, siç kërkohet nga dispozitat e pikës 1, të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, dhe duke zmadhuar ose zvogëluar masën e sanksionit, në përputhje me rrethanat (kapitulli 7).

2.3 Shkelje të sanksionueshme me masa fikse

7. Në rrethana të caktuara, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë se shkelje të caktuara mund të dënohen me sanksion administrativ në një shumë të caktuar paraprakisht. Është në diskrecionin e Zyrës së Komisionerit të përcaktojë se cilat lloje shkeljesh kualifikohen si të tilla, bazuar në natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e tyre.

8. Masat fikse të sanksioneve administrative mund të përcaktohen sipas diskrecionit të Zyrës së Komisionerit, duke marrë parasysh – ndër të tjera – rrethanat dhe situatën sociale dhe ekonomike në vend, në lidhje me seriozitetin e shkeljes, parë kjo në



harmoni me ghermat “a”, “b” dhe “e” të pikës 2 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

KAPITULLI 3 SHKELJE KONKURRUESE DHE ZBATIMI I NENIT 93(3) TË LIGJIT

9. Përpara se të përllogaritet masa e një sanksioni, bazuar në këtë metodologji, është e rëndësishme që fillimisht të merret parasysh se mbi çfarë sjelljeje (rrethanat faktike në lidhje me sjelljen) dhe shkeljeje (përshkrim abstrakt ligjor i veprimit të sanksionueshëm) bazohet masa e sanksionit. Në praktikë, një rast i veçantë mund të përfshijë rrethana që mund të konsiderohen:

- i. si një sjellje e sanksionueshme; ose si
- ii. disa sjellje të veçanta të sanksionueshme.

Gjithashtu, është e mundur që një sjellje e vetme të mund të shkaktojë një numër shkeljesh të ndryshme, të cilat mund të përjashtojnë njëra-tjetrën ose mund të bashkë qëndrojnë/renditen te njëra-tjetra. Me fjalë të tjera, mund të ketë raste shkeljesh konkurruese/të njëkohshme. Në varësi të rregullave të konkurrueshmërisë, këto shkelje mund të shpiten në përllogaritje të ndryshme sanksionesh.

10. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në lidhje me rregullat mbi

rastet konkurrenca të shkeljeve, si dhe duke marrë parasysh qëllimet e ndryshme të zbatimit të tyre si dhe pasojat ligjore, këto parime mund të grupohen përafërsisht në tri kategori si vijon:

- Konkurrenca e shkeljeve (nënkapitulli 3.1.1).
- Uniteti i veprimit (nënkapitulli 3.1.2),
- Shumësia e veprimeve (kapitulli 3.2).

11. Këto kategori të ndryshme konkurrenca nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, por kanë fusha të ndryshme zbatimi dhe përshtaten në një sistem të përgjithshëm koherent, duke parashikuar një skemë testimi logjik.

12. Prandaj, është e rëndësishme që, së pari, të përcaktohet:


a) nëse rrethanat duhet të konsiderohen si një sjellje e sanksionueshme (kapitulli 3.1) ose sjellje të shumta të sanksionueshme (kapitulli 3.2);

b) në rast të një sjelljeje të sanksionueshme (kapitulli 3.1), nëse kjo sjellje shkakton, ose jo, një ose më shumë shkelje; dhe

c) në rast të një sjelljeje që shkakton shkelje të shumta, atribuimi i një shkeljeje përjashton atribuimin e një shkeljeje tjetër (nënkapitulli 3.1.1) ose nëse ato bashkëqendrojnë i nënrenditen njëra-tjetrës (nënkapitulli 3.1.2).



DIAGRAMË:



3.1 Një sjellje e sanksionueshme

13. Si hap i parë, është thelbësore të përcaktohet nëse ka një sjellje të sanksionueshme, apo ka shumë të tilla, në mënyrë që të identifikohet sjellja përkatëse e sanksionueshme që do të jetë subjekt sanksioni. Prandaj, është e rëndësishme të kuptohet se cilat rrethana konsiderohen si një sjellje e njëjtë, në krahasim me sjellje të shumta. Sjellja përkatëse e sanksionueshme duhet të vlerësohet dhe identifikohet rast pas rasti. Për shembull, në një rast të caktuar, procese/veprimtari të njëjta ose të lidhura përpunimi të dhënash mund të përbëjnë një (të njëjtën) sjellje.

14. Termi “proces/veprimtari përpunimi” përfshihet në pikën 16, të nenit 5, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, ku me “përpunim” përkufizohet “çdo veprim ose një grup veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, përafrimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.”.

15. Gjatë vlerësimit të “procese/veprimeve të njëjta ose të lidhura të përpunimit” duhet mbajtur parasysh se Zyra e Komisionerit mund të



marrë në konsideratë, për vlerësimin e shkeljeve, të gjitha dispozitat ligjore që detyrojnë kryerjen në mënyrë të ligjshme të proceseve/veprimtarive të përpunimit, duke përfshirë për shembull, detyrimet e transparencës (p.sh. neni 13, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave). Kjo theksohet edhe me shprehjen “për procese/veprimtari përpunimi të njëjta ose të lidhura”, e cila tregon se objekti i kësaj dispozite përfshin çdo shkelje që lidhet dhe mund të ketë ndikim në të njëjtat procese/veprimtari përpunimi ose të lidhura.

16. Termi “i lidhur” i referohet parimit, sipas të cilit një sjellje unitare/e vetme mund të përbëhet nga disa pjesë që kryhen nga një vullnet unitar/i njëjtë dhe janë të lidhura (në veçanti për sa i përket identitetit të subjektit të të dhënave, qëllimit dhe natyrës së përpunimit), në hapësirë dhe kohë, aq ngushtësisht sa një vëzhgues i jashtëm do t’i konsideronte ato si një sjellje koherente. Në mënyrë që të zbatohen parimet, të parandalohen shkeljet dhe të zbatohet në mënyrë efektive ligji, është e rëndësishme që të prezumohet ekzistenca e një lidhje të mjaftueshme midis proceseve/veprimtarive të përpunimit. Prandaj, këto aspekte të marrëdhënieve për një lidhje të mjaftueshme midis proceseve/veprimtarive të përpunimit duhet të vlerësohen rast pas rasti.

Shembulli 1a. Procese/veprimtari të njëjta ose të lidhura përpunimi

Një institucion financiar kërkon, nga një agjenci raportimi kredish (ARK), kryerjen e një kontrolli aftësie kredie shlyerës për një kredimarrës të caktuar. Institucioni financiar e merr këtë informacion dhe e ruan në sistemin e tij.

Megjithëse mbledhja dhe ruajtja e të dhënave të aftësisë kredi shlyerëse, nga institucioni financiar përbëjnë secila operacione/veprimtari përpunimi në vetvete, ato formojnë një grup operacionesh/veprimtarish përpunimi që kryhen me të njëjtin vullnet dhe janë të lidhura, në hapësirë dhe kohë, në një mënyrë kaq të ngushtë me njëra-tjetrën, sa që një vëzhgues i jashtëm do t’i konsideronte ato si një sjellje të vetme. Prandaj, operacionet/veprimtari të përpunimit të kryera nga institucioni financiar duhet të konsiderohen si të “lidhura” dhe përbëjnë të njëjtën sjellje.

Shembulli 1b. Procese/veprimtari të njëjta ose të lidhura përpunimi

Një ndërmjetës të dhënash vendos të ndërmarrë një veprimtari të re përpunimi: ai vendos të mbledhë – si palë e tretë – historinë e transaksioneve me

konsumatorët nga dhjetëra shitës me pakicë, pa një bazë ligjore për këtë, me qëllim kryerjen e analizave psikometrike për të parashikuar sjelljet e ardhshme të individëve, përfshirë sjelljen/anësinë e tyre në votime politike, vullnetin për të lënë punën etj. Në të njëjtin vendim, ndërmjetësi i të dhënave vendos të mos e regjistrojë këtë procedurë në regjistrat e veprimtarive të përpunimit, të mos informojë subjektet e të dhënave dhe të shpërfillojë çdo kërkesë për akses të tyre në lidhje me operacionet e reja të përpunimit.

Veprimet e përpunimit të përfshira në këtë veprimtari përpunuese formojnë një sërë procesesh/veprimtarish përpunimi që kryhen me një vullnet unitar/ të njëjtë dhe janë të lidhura në hapësirë dhe kohë. Ato duhet të konsiderohen si të “lidhura” dhe që formojnë të njëjtën sjellje. Këtu përfshihet edhe mosregjistrimi i veprimtarisë së përpunimit në regjistrat përkatës, mosinformimi i subjekteve të të dhënave dhe mospërcaktimi i procedurave për të respektuar të drejtën e aksesit në lidhje me operacionet e reja të përpunimit. Këto detyrime janë shkelur për proceset/veprimtari të lidhura të përpunimit.

Shembulli 1c. Procese përpunimi të ndryshme dhe të pavarura

i) Një kontrollues në fushën e ndërtimit kryen kontrollin e historikut të një kandidati për punë. Kontrolli i historikut përfshin edhe orientimin politik, anëtarësimin në sindikata dhe orientimin seksual.

ii) Pesë ditë më vonë, subjekti në fjalë kërkon nga kontraktorët e tij (tregtarët individualë) një vetëdeklarim të tepruar në lidhje me marrëveshjet e tyre të biznesit me palë të tjera, pavarësisht se kjo nuk lidhet me kontratën në fuqi midis tyre ose detyrimet e përputhshmërisë ligjore, të përcaktuara nga legjislacioni i fushës.

iii) Një javë më vonë, kontrolluesi në fjalë bëhet subjekt cenimi (rrjedhjeje/humbjeje – data breach) të të dhënave të përpunuara prej tij. Rrjeti i kontrolluesit është hakuar – pavarësisht se ka masa të përshtatshme teknike dhe organizative – dhe hakeri përkatës ka fituar akses në një sistem që përpunon të dhënat personale të qytetarëve që kishin paraqitur kërkesa pranë kontrolluesit në fjalë. Pavarësisht se të dhënat ishin enkriptuar në mënyrë të përshtatshme në përputhje me standardet e zbatueshme, hakeri është në gjendje t’i thyejë ato me teknologjinë e deshifrimit ushtarak dhe i shtet të dhënat në rrjetin e errët (dark web). Subjekti i ndërtimit nuk njofton Zyrrën e



Komisionerit për cenimin (data breach) në fjalë, pavarësisht detyrimit të tij për ta bërë këtë.

Proceset/veprimtaritë e përpunimit në këtë rast, d.m.th. kontrolli i historikut të kandidatit për punë, kërkesat për vetëdeklarim drejtuar kontraktorëve dhe mosnjohimi i Zyrës së Komisionerit për cenimin e të dhënave personale, nuk janë të lidhura në vetvete. Prandaj, ato nuk duhet të konsiderohen si procese/veprimtari “të lidhura”, por, përkundrazi, ato përbëjnë sjellje të ndryshme (jo të njëjta).

17. Kur konstatohet se rrethanat e çështjes përbëjnë të njëjtën sjellje dhe shkaktojnë një shkelje të vetme, sanksioni mund të përllogaritet bazuar në atë shkelje dhe në tavanin ligjor për masën e sanksionit. Megjithatë, nëse rrethanat e çështjes formojnë të njëjtën sjellje, por kjo sjellje shkakton jo vetëm një, por disa shkelje, duhet të vërtetohet nëse ato shkelje përjashtojnë njëra-tjetrën (nënkapitulli 3.1.1), apo bashkëqendrojnë/nënrenditen të njëra-tjetra (kapitulli 3.1.2). Kur rrethanat e çështjes formojnë sjellje të shumta, ato duhet të konsiderohen si një tërësi veprimesh dhe të trajtohen në përputhje me kapitullin 3.2.

3.1.1 Konkurrenca e shkeljeve

18. Parimi i konkurrencës së shkeljeve³ është i zbatueshëm në çdo rast kur zbatimi i një dispozite të ligjit përjashton ose përthith zbatimin e një dispozite tjetër. Me fjalë të tjera, konkurrenca ndodh tashmë në nivelin abstrakt të dispozitave ligjore. Kjo mund të ndodhë bazuar në parimin e specialitetit, subsidiaritetit ose konsumit, të cilët shpesh janë të zbatueshëm kur dispozitat e ligjit mbrojnë të njëjtin interes ligjor. Në raste të tilla, do të ishte e paligjshme të sanksionohej dy herë shkelësi për të njëjtën shkelje.

19. Në rastin e konkurrencës së shkeljeve, masa e sanksionit duhet të përllogaritet vetëm në bazë të shkeljes së identifikuar sipas rregullave të mësipërme (shkelja mbizotëruese).

Parimi i specialitetit

20. Parimi i specialitetit (*specialia generalibus derogant*) është një parim juridik që nënkupton se një dispozitë më specifike (që rrjedh nga i njëjti akt ligjor ose akte të ndryshme ligjore të së njëjtës fuqi juridike) zëvendëson një dispozitë më të përgjithshme, megjithëse të dyja ndjekin të njëjtin

objektiv. Shkelja më specifike konsiderohet ndonjëherë si një “lloj i kualifikuar” shkeljeje krahasuar me atë më pak specifike. Lloji i kualifikuar i shkeljes mund t’i nënshtrohet një niveli më të lartë sanksioni, një tavan ligjor më të lartë ose një afati më të gjatë parashkrimi.

21. Megjithatë, ndonjëherë, nëpërmjet teknikës së interpretimit, parimi i specialitetit mund të zbatohet edhe në rastet kur, për shkak të natyrës dhe sistematikës, një shkelje konsiderohet si kualifikim i një shkeljeje tjetër dukshëm më specifike, ndonëse formulimi i saj nuk përmend në mënyrë eksplicite një element shtesë.

22. Kur dy dispozita ndjekin objektiva të ndryshëm nga njëra-tjetra, ky përbën një faktor diferencues që justifikon vendosjen e sanksioneve të veçanta. Për shembull, nëse një shkelje e një dispozite rezulton automatikisht në shkelje të tjetrës, por e kundërta nuk ndodh, këto shkelje ndjekin objektiva të ndryshëm.

23. Parimi i specialitetit mund të zbatohet vetëm nëse, si dhe për atë që, objektivat e ndjekur nga shkeljet përkatëse janë në të vërtetë të ngjashme në çështjen individuale. Meqenëse, parimet e mbrojtjes së të dhënave, të parashikuara në nenin 6 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, janë përcaktuar si koncepte gjithëpërfshirëse, mund të ketë situata kur dispozita të tjera janë konkretizim i këtij parimi, por që nuk e kufizojnë parimin në tërësinë e tij. Me fjalë të tjera, një dispozitë nuk përcakton gjithmonë shtrirjen e plotë të parimit. Prandaj, në varësi të rrethanave, në disa raste, ato mbivendosen në mënyrë të ngjashme dhe një shkelje mund të zëvendësojë tjetrën, ndërsa në raste të tjera mbivendosja është vetëm e pjesshme dhe për këtë arsye jo plotësisht e njëjtë. Përderisa ato nuk janë të ngjashme, nuk ka përputhje të shkeljeve. Në vend të kësaj, ato mund të konsiderohen krahas njëra-tjetrës, në kuadër të përllogaritjes së sanksionit.

Parimi i subsidiaritetit

24. Një formë tjetër e konkurrencës së shkeljeve shpesh përmendet si parimi i subsidiaritetit. Ai zbatohet nëse një shkelje konsiderohet si subsidiare e një shkeljeje tjetër. Kjo mund të ndodhë ose sepse ligji parashikon formalisht subsidiaritetin ose sepse subsidiariteti

³ I referuar edhe si “konkurrenca në dukje” ose “konkurrenca false”.



ekziston për arsye materiale. Ky i fundit mund të jetë rasti kur shkeljet kanë të njëjtin objektiv, por njëra përmban një rëndesë më të vogël në raport me tjetrën (p.sh., një shkelje e natyrës administrative mund të jetë subsidiare ndaj një shkeljeje të natyrës penale etj.).

Parimi i konsumit

25. Parimi i konsumit zbatohet në rastet kur shkelja e njëres dispozitë sjell shkeljen e tjetrës, shpesh për shkak se njëra shkelje i paraprin tjetrës.

3.1.2 Uniteti i veprimit – neni 93(3) i ligjit

26. Në mënyrë të ngjashme me situatën e konkurrencës së shkeljeve, parimi i unitetit të veprimit⁴ zbatohet në rastet kur një sjellje është objekt rregullimi nga disa dispozita ligjore, me ndryshimin se asnjë dispozitë nuk përjashtohet si dhe nuk përthithet te tjetra, sepse nuk bien në fushën e zbatimit të parimeve të specialitetit, subsidiaritetit apo konsumit dhe, më së shumti, ndjekin objektiva të ndryshëm.

27. Parimi i unitetit të veprimit është specifikuar në pikën 3 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave në formën e një “uniteti përpunimi”. Është e rëndësishme të kuptohet se pika 3 e nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave është e kufizuar në zbatimin e tij dhe nuk do të zbatohet për çdo rast në të cilin konstatohet se kanë ndodhur shkelje të shumëfishta, por vetëm për ato raste kur shkeljet e shumëfishta kanë rezultuar nga procese/veprimtari të njëjta, ose të lidhura përpunimi siç shpjegohet më sipër. Në këto raste, shuma totale e sanksionit administrativ nuk duhet të tejkalojë shumën e specifikuar për shkeljen më të rëndë.

28. Nëse një kontrollues ose përpunues ka shkelur dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave, me dashje ose pakujdesi, për procese/veprimtari të njëjta ose të lidhura përpunimi, masa totale e sanksionit nuk duhet të tejkalojë shumën për shkeljen më të rëndë (neni 93(3) i ligjit).

29. Në disa raste të veçanta mund të supozohet gjithashtu një unitet veprimi, kur një veprim i vetëm shkel disa herë të njëjtën dispozitë ligjore. Ky mund të jetë veçanërisht rasti, kur rrethanat shkaktojnë një shkelje të përsëritur dhe të ngjashme të së njëjtës dispozitë ligjore në një vazhdimësi të ngushtë në hapësirë dhe kohë.

Shembulli 2. Uniteti i veprimit

Një kontrollues u dërgon grupeve të ndryshme të subjekteve të të dhënave një mori e-mail-esh marketingu, në frekuencë të ndryshme gjatë një dite, pa pasur një bazë ligjore dhe kështu shkel, me unitet veprimi, disa herë pikën 1 të nenit 7 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

30. Përmbajtja e pikës 3 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave duket sikur nuk e mbulon drejtpërdrejt këtë rast të fundit të unitetit të veprimit, pasi nuk duket sikur janë shkelur “disa dispozita të ligjit”. Megjithatë, do të përbënte trajtim të pabarabartë dhe të padrejtë, nëse një shkelës, i cili me një veprim shkel dispozita të ndryshme që ndjekin objektiva të ndryshëm, do të privilegjohej kundrejt një shkelësi që shkel me të njëjtin veprim të njëjtën dispozitë, që ndjek të njëjtin objektiv, disa herë. Për të shmangur mospërpunueshmërinë e parimit ligjor dhe për të respektuar të drejtën themelore për trajtim të barabartë, në raste të tilla, pika 3 e nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave do të zbatohet *mutatis mutandis*.

31. Në rast uniteti veprimi, masa totale e sanksionit nuk duhet të tejkalojë tavanin ligjor të zbatueshëm për shkeljen më të rëndë. Sa i përket interpretimit të pikës 3 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, vlen të theksohet se, bazuar në parimin e interpretimit të normës sipas qëllimit të saj (*effet utile*) – në përcaktimin e masës së sanksionit – kjo dispozitë nuk duhet interpretuar në një mënyrë që relativizon faktin nëse shkelësi ka kryer një ose shumë shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

32. Termi “masa totale” nënkupton që të gjitha shkeljet e kryera duhet të merren parasysh kur vlerësohet masa e sanksionit dhe fraza “shuma e parashikuar për shkeljen më të rëndë” e pikës 3 të nenit 93 i referohet tavanëve ligjore të sanksioneve (sipas nenit 94 të ligjit). Prandaj, megjithëse vetë sanksioni nuk mund të tejkalojë tavanin ligjor të nivelit më të lartë të tij, kur vlerësohet masa e sanksionit përfundimtar, shkelësi do të konsiderohet, gjithsesi, shprehimisht fajtor për shkeljen e disa dispozitave dhe këto shkelje duhet të merren parasysh për këtë qëllim.

⁴ I referuar edhe si “konkurrencë ideale”.



3.2 Shumësia e veprimeve të sanksionueshme

33. Parimi i shumësisë së veprimeve⁵ përshkruan të gjitha rastet që nuk përfshihen në parimet e konkurrencës së shkeljeve (nënkapitulli 3.1.1) ose në pikën 3 e nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (nënkapitulli 3.1.2).

34. Arsyeja e vetme që këto shkelje trajtohen në një vendim të vetëm lidhet me faktin se ato tërheqin në mënyrë rastësore vëmendjen e inspektorëve të Zyrës së Komisionerit, në të njëjtën kohë, pa qenë veprime të njëjta ose të lidhura përpunimi, në kuptim të pikës 3 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave. prandaj, në këtë rast, konstatohet se shkelësi ka shkelur disa dispozita ligjore dhe sanksionohet administrativisht me sanksione të veçanta në të njëjtin vendim ose në vendime të veçanta të Komisionerit. Për më tepër, meqenëse pika 3 e nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave nuk zbatohet, masa totale e sanksionit mund të kalojë shumën e specifikuar për shkeljen më të rëndë (*argumentum e contrario*). Rastet e shumësisë së veprimeve nuk paraqesin asnjë arsye për të privilegjuar shkelësin në lidhje me përllogaritjen e masës së sanksionit. Megjithatë, kjo nuk cenon detyrimin për të respektuar parimin e përgjithshëm të proporcionalitetit.

Shembulli 3. Shumësia e veprimeve

Pas kryerjes së një inspektimi për mbrojtjen e të dhënave në ambientet e një kontrolluesi, Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë procedurë për rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së faqes së tij të internetit, për t'u ofruar punonjësve informacionin e nenit 13 të ligjit në lidhje me përpunimin e të dhënave të burimeve njerëzore dhe për të informuar Zyrën e Komisionerit për një cenim të kobëve të fundit të të dhënave (data breach) të përpunuara/mbledhura nga kontraktorët e tij. Asnjë nga shkeljet nuk përjashtohen nga, ose përfshihen tek, njëra-tjetra në bazë të specialitetit, subsidiaritetit ose konsumit. Gjithashtu, ato nuk kualifikohen si veprimtari të njëjta përpunimi

ose veprimtari të lidhura përpunimi; kështu, ato nuk përbëjnë unitet veprimi, por një shumësi veprimesh. Prandaj, Zyra e Komisionerit do të konstatojë shkelje të ndryshme të neneve 13, 28 dhe 29 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave. Për këtë arsye, kontrolluesi do të sanksionohet me sanksione individuale për secilën shkelje, pa u kufizuar nga një tavan i vetëm ligjor i zbatueshëm për shumën e tyre.

KAPITULLI 4

PIKËNISJA E PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SANKSIONIT ADMINISTRATIV

35. Zyra e Komisionerit vlerëson se përllogaritja e masës së sanksionit duhet të fillojë nga një pikënisje e caktuar⁶. Kjo pikënisje përbën fillimin për përllogaritjen e mëtejshme të sanksionit, ku merren parasysh dhe vlerësohen të gjitha rrethanat e çështjes, duke rezultuar në masën përfundimtare të sanksionit që do t'i vendoset kontrolluesit dhe/ose përpunuesit përkatës.

36. Identifikimi i pikënisjes për përllogaritjen e masës së sanksionit nuk ndikon në vendimmarrjen e Komisionerit për të marrë në konsideratë çdo rast shkeljeje rrethanat përkatëse. Sanksioni i vendosur ndaj një kontrolluesi/përpunuesi mund të variojë nga masa minimale deri në tavanin e parashikuar në ligj, me kusht që ky sanksion administrativ të jetë efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues. Ekzistenca e një pikënisjeje nuk e pengon Komisionerin për të rritur masën e sanksionit (deri në tavanin ligjor), nëse këtë e kërkojnë rrethanat e çështjes.

37. Zyra e Komisionerit konsideron tri elemente thelbësore në përcaktimin e pikënisjes për përllogaritjen e sanksionit:

i. kategorizimin e shkeljeve sipas natyrës, sipas nenit 94, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave;

ii. shkallën e rëndësisë së shkeljeve, bazuar në pikën 2 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave; si dhe

⁵ I referuar edhe si “konkurrencë reale”, “konkurrencë faktike” ose “konkurrencë e rastësishme”.

⁶ Gjykata e Drejtësisë në përgjithësi pranon që llogaritjet të fillojnë nga një pikënisje abstrakte. Veçanërisht në çështjet e përbashkëta C-189/02 P, C-202/02 P, C-205/02 P deri C-

208/02 P dhe C-213/02 P, Dansk Rørindustri, por edhe në ato të kohëve më të fundit, si çështja T- 15/02, BASF AG kundër Komisionit, paragrafi 120-121; 134, çështja C-227/14 P, LG Display Co. Ltd kundër Komisionit, paragrafi 53 dhe çështja T-26/02, Daiichi Pharmaceutical Co. Ltd kundër Komisionit, paragrafi 50.



iii. xhiron e ndërmarrjes, të cilët merren në konsideratë, me synim vendosjen e një sanksioni efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues, bazuar në pikën 1 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave. Këto elemente sqarohen në kapitujt 4.1, 4.2 dhe 4.3 në vijim.

4.1 Kategorizimi i shkeljeve sipas nenit 94 të ligjit

38. Pothuajse të gjitha detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve janë kategorizuar, sipas natyrës së tyre, në dispozitat e nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilat parashikohen dy kategori shkeljesh: i) shkeljet e sanksionueshme sipas pikës 1, të nenit 94; dhe ii) shkelje të sanksionueshme sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 94. Kategoria e parë e shkeljeve dënohet me sanksion deri në 1 000 000 000 lekë ose 2% të xhiros vjetore, për vitin financiar paraardhës të kontrolluesit/përpunuesit, cilado është më e lartë. Ndërsa rasti i dytë dënohet me sanksion deri në 2 000 000 000 lekë ose 4% të xhiros vjetore për vitin financiar paraardhës të kontrolluesit/përpunuesit, cilado është më e lartë.

39. Me këtë dallim, ligjvënësi ka përcaktuar treguesin e parë të shkallës së rëndësisë së një shkeljeje në kuptimin abstrakt. Sa më e rëndë të jetë shkelja, aq më e madhe mund të jetë masa e sanksionit.

4.2 Shkalla e rëndësisë së shkeljes sipas rrethanave në çdo rast individual

40. Gjithashtu, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, parashikon se duhen të merren në konsideratë rrethanat që cilësojnë seriozitetin e shkeljes në një çështje individuale. Me fjalë të tjera, ligji kërkon që Zyra e Komisionerit të marrë në konsideratë natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes, duke pasur parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e përpunimit përkatës, si dhe numrin e subjekteve të të dhënave, të prekura nga kjo shkelje si dhe nivelin e dëmit të shkaktuar ndaj tyre (neni 93(2)(a) i ligjit); karakterin e qëllimshëm (dashjen) ose pakujdesinë (neni 93(2)(b) i ligjit); dhe kategoritë e të dhënave personale të prekura nga shkelja (neni 93(2) (e) i ligjit).

41. Zyra e Komisionerit analizon këto elemente në dritën e rrethanave të çështjes përkatëse dhe konkludon – në bazë të kësaj analize – në lidhje me shkallën e rëndësisë së shkeljes (siç do të trajtohen në vijim, te paragrafi numër 49). Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit

mund të marrë gjithashtu në konsideratë, nëse e dhëna përkatëse ishte drejtpërdrejt e identifikueshme. Edhe pse ata trajtohen individualisht në këtë metodologji, në praktikë, këto elemente janë shpesh të ndërthurura dhe duhen parë në lidhje me faktet e çështjes, në tërësi.

4.2.1 Natyra, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes

42. Germa “a” e pikës 2 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka një objekt të gjerë dhe kërkon që Zyra e Komisionerit të kryejë një shqyrtim të plotë të të gjitha elementeve që përbëjnë një shkelje të caktuar, të cilat mjaftojnë për ta diferencuar atë nga shkelje të tjera të të njëjtit lloj. Ky vlerësim duhet të marrë në konsideratë elementet specifike, si vijon:

a) Natyrën e shkeljes, e vlerësuar në bazë të rrethanave konkrete të çështjes. Në këtë kuptim, kjo analizë është më specifike sesa klasifikimi abstrakt i pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 94 i ligjit. Zyra e Komisionerit mund të marrë parasysh edhe interesin që synon të mbrojë dispozita e shkelur dhe vendin e saj në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit mund të marrë në konsideratë shkallën në të cilën shkelja përkatëse ka penguar zbatimin efektiv të dispozitës dhe përmbushjen e objektivit që ajo synon të mbrojë;

b) Rëndësinë e shkeljes, e vlerësuar në bazë të rrethanave konkrete të çështjes. Siç përcaktohet në germën “a” të pikës 2, të nenit 93 të ligjit. Tregues për rëndësinë e shkeljes janë natyra e përpunimit, por edhe objekti dhe qëllimi i tij, si dhe numri i subjekteve të të dhënave të prekura dhe niveli i dëmit që u është shkaktuar atyre.

i. Natyra e përpunimit, duke përfshirë kontekstin për të cilin kryhet ky përpunim (p.sh. veprimtari biznesi, veprimtari jofitimprurëse, parti politike etj.), si dhe të gjitha karakteristikat e përpunimit. Kur natyra e përpunimit sjell rreziqe më të larta, p.sh. kur qëllimi është monitorimi i sjelljeve, vlerësimi i aspekteve personale ose marrja e vendimeve ose masave me efekte negative për subjektet e të dhënave, në varësi të kontekstit të përpunimit dhe rolit të kontrolluesit ose përpunuesit, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë t'i japë më shumë peshë këtij faktori. Gjithashtu, mund t'i kushtohet rëndësi vlerësimit të këtij faktori, kur subjekti i të dhënave dhe kontrolluesit janë në kushte të pabarabarta (p.sh.



kur subjektet e të dhënave janë punonjës, nxënës ose pacientë) ose kur përpunimi përfshin një kategori subjektësh lehtësisht të cenueshme (vulnerabël) të dhënash, veçanërisht fëmijët/të miturit.

ii. Objekti i përpunimit, bazuar në objektin vendas ose ndërkufitar të përpunimit të kryer dhe marrëdhënies midis këtij informacioni dhe shtrirjes/gjerësisë reale të përpunimit, referuar burimeve të alokuara për këtë qëllim nga kontrolluesi. Ky element nxjerr në pah një faktor real rreziku, të lidhur me vështirësinë gjithnjë e më të madhe për subjektin e të dhënave dhe Zyrën e Komisionerit për të frenuar sjelljen e paligjshme, ndërsa objekti i përpunimit zmadhohet. Sa më i madh të jetë objekti i përpunimit, aq më shumë peshë mund t'i japë Zyra e Komisionerit këtij faktori.

iii. Qëllimi i përpunimit është një faktor që Zyra e Komisionerit i jep shumë peshë, duke shqyrtuar, gjithashtu, nëse qëllimi (i përpunimit) përbën të ashtuquajturën veprimtari thelbësore (*core activity*) të kontrolluesit. Sa më qendror të jetë përpunimi në veprimtaritë thelbësore të kontrolluesit ose përpunuesit, aq më të rënda do të jenë parregullsitë në këtë përpunim. Në këto rrethana, ky faktor merr më shumë rëndësi/peshë. Megjithatë, mund të ketë rrethana në të cilat përpunimi i të dhënave personale nuk përbën më tej veprimtari thelbësore të kontrolluesit ose përpunuesit, por ndikon ndjeshëm në vlerësim (ky është rasti, p.sh., i përpunimit lidhur me të dhënat personale të punonjësve, ku shkelja ndikon ndjeshëm në dinjitetin e tyre).

iv. Numri i subjekteve të të dhënave të cenuar konkretisht, por edhe potencialisht. Sa më i madh të jetë numri i subjekteve të të dhënave të përfshira, aq më shumë peshë mund t'i japë Zyra e Komisionerit vlerësimit të këtij faktori. Në shumë raste mund të konsiderohet, gjithashtu, se shkelja merr një natyrë sistemike/tërësore dhe për këtë arsye, mund të ndikojë në kohë të ndryshme, edhe subjekte të tjera të dhënash të cilët nuk kanë paraqitur ankesa pranë Zyrës së Komisionerit. Zyra e Komisionerit, në varësi të rrethanave të rastit, mund të marrë në konsideratë raportin midis numrit të subjekteve të të dhënave të prekura dhe numrit total të subjekteve të të

dhënave në atë kontekst (p.sh. numri i qytetarëve, klientëve ose punonjësve) për të vlerësuar nëse shkelja është e një natyre sistemike.

v. Niveli i dëmit të pësuar dhe shkalla në të cilën sjellja mund të ndikojë në të drejtat dhe liritë individuale. Për këtë arsye, referimi për “*nivelin*” e dëmit të pësuar synon të tërheqë vëmendjen e Zyrës së Komisionerit për dëmin e shkaktuar, ose që mund të ishte shkaktuar, si një parametër tjetër, i veçantë, në lidhje me numrin e subjekteve të të dhënave të përfshira (p.sh., në rastet kur numri i individëve të prekur nga përpunimi i paligjshëm është i madh, por dëmi i pësuar prej tyre është marginal/dytësor). Shkalla e dëmit të shkaktuar i referohet dëmit fizik, material ose jomaterial⁷. Vlerësimi i dëmit, në çdo rast, kufizohet në atë që është funksionalisht e nevojshme për të arritur vlerësimin e saktë të shkallës së rëndësisë së shkeljes, siç tregohet në paragrafin 49 më poshtë, kjo pa krijuar mbivendosje me veprimtarinë e autoriteteve gjyqësore të ngarkuara për të konstatuar format e ndryshme të dëmit individual.

c) Kohëzgjatjen e shkeljes, e cila nënkupton që Zyra e Komisionerit, mund t'i japë më shumë peshë një shkeljeje me kohëzgjatje më të madhe. Nëse një sjellje e caktuar ishte e paligjshme sipas kuadrit të mëparshëm rregullator, mund të merren parasysh në përcaktimin e masës së sanksionit administrativ, si periudha pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit të ri ashtu edhe periudha e mëparshme, mund të merren parasysh në përcaktimin e masës, në çdo rast, duke marrë parasysh edhe përcaktimet e kuadrit të mëparshëm ligjor.

43. Zyra e Komisionerit mund t'u kushtojë rëndësi faktorëve të sipërpërmendur, në varësi të rrethanave të çështjes. Nëse nuk kanë peshë të veçantë në një çështje specifike, ato mund të mos merren në konsideratë për rastin.

4.2.2 Karakteri i qëllimshëm (dashja) ose pakujdesia

44. Në praktikën e BE-së, në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe bazuar në qëndrimin e BEMD, në përgjithësi, “*qëllim*” përfshin, të dyja, njohurinë dhe vullnetin (keqdashës) në lidhje me karakteristikat e një shkeljeje, ndërsa termi “*i paqëllimshëm*” nënkupton se nuk ka pasur qëllim për të shkaktuar shkelje

⁷ Shih recitalin 75 të rregullores së BE-së.



pavarësisht se kontrolluesi/përpunuesi ka shkelur detyrimin për kujdes (*duty of care*) që kërkohet me ligj⁸. E paqëllimshmja, në këtë kuptim, nuk barazohet me të pavullnetshmen.

Shembulli 4. Ilustrime të qëllimit dhe neglizhencës, sipas BEMD-së

Rrethanat që tregojnë për shkelje të qëllimshme mund të jenë përpunimi i paligjshëm i autorizuar në mënyrë të shprehur nga hierarkia e lartë e menaxhimit/drejtesve të kontrolluesit ose përkundër këshillave nga nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave, ose në mospërfillje të politikave ekzistuese – për shembull, marrja dhe përpunimi i të dhënave për punonjësit e një konkurrenti, me synimin për ta diskredituar atë konkurrent në treg. Shembuj të tjerë këtu mund të jenë:

- ndryshimi i të dhënave personale për të shtrembëruar faktet (me qëllim dhënien e një përshtypje pozitive të pavërtetë) në lidhje me përmbushjen e objektivave;

- tregtimin e të dhënave personale për qëllime marketingu, d.m.th. shitjen e të dhënave si “opted in”, pa kontrolluar/duke shpërfillur vullnetin e subjekteve të të dhënave për mënyrën sesi duhet të përdoren të dhënat e tyre.

Rrethana të tjera, të tilla si mosleximi dhe mosrespektimi i politikave ekzistuese, gabimi njerëzor, dështimi për të kontrolluar të dhënat personale në informacionin e publikuar, moszbatimi i përditësimeve teknike në kohën e duhur, mosmiratimi i politikave (në vend të moszbatimit të tyre) mund të jenë tregues të neglizhencës.

45. Karakteri i qëllimshëm ose i pakujdesshëm i shkeljes (neni 93(2)(b) i ligjit) duhet të vlerësohet duke marrë parasysh elementet objektive të sjelljes të mbledhura nga faktet e çështjes. Siç theksohet nga BEMD-ja “përgjithësisht pranohet se shkeljet e qëllimshme, që tregojnë shpërfillje për dispozitat e ligjit, janë më të rënda se ato të paqëllimshme”.⁹ Kësisoj, në rastin e një shkeljeje të qëllimshme, Zyra e Komisionerit mund t’i kushtojë më shumë rëndësi kësaj rrethane. Varësisht rrethanave të çështjes, Zyra e Komisionerit mund t’i kushtojë rëndësi

edhe shkallës së neglizhencës, e cila, në rastin më të mirë, mund të mos merret në konsideratë për rastin.

4.2.3 Kategoritë e të dhënave personale të prekura

46. Lidhur me kërkesën për të marrë parasysh kategoritë e të dhënave personale të prekura (neni 93(2)(e) i ligjit), ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, thekson qartë llojet e të dhënave që meritojnë mbrojtje të veçantë dhe për rrjedhojë, një trajtim më të rreptë në kuadër të zbatimit të masave të sanksioneve. Kjo ka të bëjë me llojet e të dhënave të parashikuara në dispozitat e neneve 9 dhe 10 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me të dhënat jashtë fushës së këtyre neneve, shpërndarja e të cilave shkakton dëme ose shqetësime të menjëhershme për subjektin e të dhënave (p.sh., të dhënat e vendndodhjes, të dhënat për komunikimin privat, numrat personalë të identifikimit ose të dhënat financiare, të tilla si pasqyrat e transaksioneve ose numrat e kartave të kreditit)¹⁰. Në përgjithësi, sa më shumë kategori të tilla të dhënash të përfshihen, ose sa më sensitive të jenë të dhënat, aq më shumë rëndësi i jepet këtij faktori.

47. Më tej, sasia e të dhënave në lidhje me secilin subjekt të dhënash të përfshirë në një veprimtari përpunimi, është e rëndësishme, pasi cenimi i së drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale rritet proporcionalisht me sasinë e të dhënave të përpunuara për secilin subjekt të dhënash.

4.2.4 Klasifikimi i rëndësisë së shkeljes dhe identifikimi i shumës së pikënisjes së përlogaritjes së sanksionit administrativ

48. Vlerësimi i faktorëve të mësipërm (sipas nënkapitujve 4.2.1–4.2.3) përcakton rëndësinë e shkeljes në tërësi. Ky vlerësim nuk konsiston në një përlogaritje matematikore, në të cilën faktorët e sipërpërmendur merren në konsideratë individualisht, por në një vlerësim të plotë të rrethanave konkrete të çështjes, në të cilin të gjithë faktorët e sipërpërmendur janë të ndërlidhur midis

⁸ Shih udhëzimet e Grupit të Punës 253 (WP253) të BEMD-së, f. 11.

⁹ Shih udhëzimet e Grupit të Punës 253 (WP253) të BEMD-së, f. 12.

¹⁰ Përhapja e komunikimeve private dhe të dhënave të vendndodhjes mund të shkaktojë dëme ose shqetësime të menjëhershme për subjektin e të dhënave, gjë që është Faqe | 19222

theksuar nga mbrojtja e veçantë e dhënë nga ligjvënësi i BE-për komunikimet private në nenin 7 të Kartës së të Drejtave Themelore dhe Direktivës 2002/58/KE, si dhe nga GJED për të dhënat e vendndodhjes në raste të caktuara, shih çështjet e përbashkëta C-511/18, C-512/18 dhe C-520/18, La Quadrature du Net et al, paragrafi 117 dhe praktika gjyqësore e cituar atje.



tyre. Prandaj, në shqyrtimin e rëndësisë së shkëljes, duhet t'i kushtohet vëmendje shkëljes në tërësi.

49. Bazuar në vlerësimin e faktorëve të sipërpërmendur, Zyra e Komisionerit mund të konstatojë se shkëlja është e një shkalle rëndësie të ulët, mesatare ose të lartë. Këto kategori nuk ndikojnë në faktin nëse mund të vendoset apo jo një sanksion.

- Gjatë përlllogaritjes së masës së sanksionit për shkëlje të një shkalle të ulët rëndësie, Zyra e Komisionerit përcakton pikënisjen e përlllogaritjes së mëtejshme në një vlerë midis 0 dhe 10% të tavanit ligjor të zbatueshëm.

- Gjatë përlllogaritjes së masës së sanksionit për shkëlje të një shkalle rëndësie mesatare, Zyra e Komisionerit përcakton pikënisjen e përlllogaritjes së mëtejshme në një vlerë midis 10 dhe 20% të tavanit ligjor të zbatueshëm.

- Gjatë përlllogaritjes së masës së sanksionit për shkëlje të një shkalle rëndësie të lartë, Zyra e Komisionerit përcakton pikënisjen e përlllogaritjes së mëtejshme në një vlerë midis 20 dhe 100% të tavanit ligjor të zbatueshëm.

50. Si rregull i përgjithshëm, sa më e rëndë të jetë shkëlja brenda kategorisë së saj, aq më e lartë ka të ngjarë të jetë pikënisja e përlllogaritjes.

51. Diapazonet brenda të cilëve përcaktohen pikënisjet përkatëse të përlllogaritjes mbeten, gjithsesi, në vlerësimin e mëtejshëm të Zyrës së Komisionerit dhe mund të përshtaten në diskrecion të plotë të tij, nëse dhe kur paraqitet e nevojshme.

Shembulli 5a. Kualifikimi i rëndësisë së një shkëljeje (shkalla e lartë e rëndësisë)

Pas hetimit të ankesave të shumta për thirrje të pakërkuara nga klientët e një operatori telefonie, Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi në fjalë përdorte detajet e kontaktit të klientëve të tij për qëllime telemarketingu, pa një bazë ligjore të vlefshme (shkëlje e nenit 7 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale). Konkretisht, operatori i telefonisë u kishte ofruar palëve të treta emrat dhe numrat e telefonit të regjistruar të klientëve të tij për qëllime marketingu. Ky kontrollues e kishte bërë këtë pavarësisht kështillave/rekomandimeve të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave kundër një përpunimi të tillë, pa ndërmarrë asnjë përpjekje për të frenuar praktikën ose për t'u ofruar klientëve një mënyrë për të kundërshtuar këtë përpunim. Në fakt, kjo praktikë zinte fill që nga shkurti i vitit 2025 dhe

vijonte ende në momentin e hetimit. Kontrolluesi në fjalë operonte në mbarë vendin dhe praktika prekte të gjithë 1 milion klientët e tij. Zyra e Komisionerit konstatoi se të gjithë këta klientët u ishin nënshtruar rregullisht thirrjeve të pakërkuara nga palë të treta, pa asnjë mjet efektiv për t'i ndaluar ato.

Zyra e Komisionerit kishte për detyrë të vlerësonte rëndësinë e këtij rasti. Si pikënisje, Zyra e Komisionerit vuri në dukje se një shkëlje e nenit 7 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale renditet ndër shkëljet e parashikuara në pikën 2, të nenit 94 të ligjit dhe, për këtë arsye, ajo kategorizohet në shkallën më të lartë të shkëljes të parashikuar nga ky nen. Së dyti, Zyra e Komisionerit vlerësoi rrethanat e çështjes. Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit i kushtoi një rëndësi të madhe **natyrës së shkëljes**, pasi dispozita e shkëlur (neni 7 i ligjit) mbështet ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave në tërësi. Mosrespektimi i kësaj dispozite cenon ligjshmërinë e përpunimit në tërësi. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit i kushtoi rëndësi të madhe edhe **kohëzgjatjes së shkëljes**, e cila filloi me hyrjen në fuqi të ligjit dhe nuk ishte ndërprerë deri në momentin e hetimit. Fakti që kontrolluesi operonte në shkallë vendi, i dha rëndësi objektit të përpunimit. **Numri i subjekteve të të dhënave** të përfshira u konsiderua shumë i lartë (1 milion, krahasuar me numrin total të popullsisë, prej 3 milionë banorësh), ndërsa **shkalla e dëmit të pësuar** prej tyre u konsiderua e moderuar (dëm jo material, në formën e shqetësimit). Ky vlerësim u krye duke marrë parasysh **kategoritë e të dhënave të prekura** (emri dhe numri i telefonit). Megjithatë, rëndësia e shkëljes u rrit nga fakti se ajo ishte kryer në kundërshtim me kështillën e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave dhe, për rrjedhojë, u konsiderua e **qëllimshme**.

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër (natyrën e rëndë, kohëzgjatjen e madhe, numrin e madh të subjekteve të të dhënave, shtrirjen mbarëkombëtare, natyrën e qëllimshme, kundrejt një dëmi të moderuar), Zyra e Komisionerit konkludoi se shkëlja konsiderohet e një shkalle rëndësie të lartë. Për këtë arsye, si pikënisje për përlllogaritjen e masës së sanksionit, Zyra e Komisionerit përcaktoi një vlerë midis 20% dhe 100% të tavanit ligjor, të parashikuar në pikën 2, të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Shembulli 5b. Kualifikimi i rëndësisë së një shkëljeje (shkalla mesatare e rëndësisë)

Zyra e Komisionerit mori një njoftim për shkëljen e të dhënave personale nga një spital. Nga ky njoftim,



rezultoi se disa anëtarë të stafit kishin mundur të aksesonin (shihnin) pjesë të kartelave shëndetësore të pacientëve që – nisur nga pavijoni ku punonin – nuk duhej të ishin të aksesueshme për ta. Spitali ishte duke punuar për përcaktimin e procedurave që rregullojnë aksesin në kartelat e pacientëve dhe kishte zbatuar masa të rrepta për akses të kufizuar. Kjo nënkuptonte që stafi i një pavioni mund të kishte akses vetëm në informacionin mjekësor që lidhej me atë pavijon specifik. Përveç kësaj, spitali kishte investuar në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e privatësisë tek anëtarët e stafit të tij. Megjithatë, siç rezultoi nga hetimi administrativ, spitali kishte probleme në lidhje me monitorimin e autorizimeve të aksesit në të dhënat e përpunuara. Anëtarët e stafit që transferoheshin midis pavioneve ishin ende në gjendje të kishin akses në kartelat e pacientëve të shtruar në pavionet e tyre të mëparshme dhe spitali nuk kishte procedura në fuqi për të përshtatur pozicionin aktual të anëtarit të stafit me autorizimin e tyre. Nga hetimi i brendshëm i spitalit rezultoi se, të paktën, 150 anëtarë të stafit (nga 3500) kishin autorizime të pasakta, duke prekur të paktën 20 mijë nga 95 mijë kartela të pacientëve. Spitali mundi të provojë se, të paktën, në 16 raste, anëtarët e stafit kishin përdorur autorizimet e tyre për të parë kartelat e pacientëve. Zyra e Komisionerit vlerësoi se ka pasur shkelje të nenit 28 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në vlerësimin e rëndësisë të shkeljes në këtë çështje, Zyra e Komisionerit, fillimisht, vuri në dukje se një shkelje e nenit 28, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale renditet ndër shkeljet e pikës 1 të nenit 94 të ligjit dhe, për këtë arsye, ajo **kategorizohet në masën më të lehtë të sanksionit sipas nenit në fjalë**. Së dyti, Zyra e Komisionerit vlerësoi rrethanat e rastit. Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit konsideroi se edhe pse **numri i subjekteve të të dhënave** të prekura nga shkelja ishte vetëm 16, potencialisht, ky numër mund të ishte 20 mijë bazuar në rrethanat e rastit deri, madje, 95 mijë, duke pasur parasysh natyrën sistemike të çështjes. Më tej, Zyra e Komisionerit e kategorizoi shkeljen si **pakujdesi (neglizhencë)**, por jo e një rëndësie të lartë, e cila u konsiderua si një faktor pa ndikim në rrethanat e këtij rasti të veçantë, për faktin se spitali nuk kishte miratuar politikat e autorizimit, gjë që, me siguri, duhej ta kishte bërë, por, nga ana tjetër, kishte ndërmarrë hapa për të zbatuar masa të rrepta për të kufizuar aksesin. Ky vlerësim nuk u ndikua nga fakti se politika të tjera të mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave u zbatuan

me sukses, siç kërkojnë dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në fund, Zyra e Komisionerit i kushtoi rëndësi të madhe faktit se kartelat e pacientëve përmbanin të dhëna shëndetësore, të cilat janë **të dhëna sensitive**, sipas nenit 9, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër (natyrën e përpunimit dhe faktin që të dhënat ishin sensitive, përkundrejt numrit të subjekteve të të dhënave të prekur realisht dhe potencialisht, Zyra e Komisionerit konkludoi se shkelja konsiderohet të jetë e një **shkalle rëndësie mesatare**. Zyra e Komisionerit përcaktoi si pikënisje të përlllogaritjes së mëtejshme të sanksionit në një vlerë midis 10 dhe 20% të tavanit ligjor të parashikuar në pikën 1, të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Shembulli 5c. Kualifikimi i rëndësisë së një shkeljeje (shkalla e ulët e rëndësisë)

Zyra e Komisionerit ka marrë ankesa të shumta për mënyrën se si një dyqan online trajton të drejtën e aksesit të të dhënave të subjekteve të tij. Sipas ankuesve, trajtimi i kërkesave të tyre për akses ka zgjatur nga 4 deri në 6 muaj, që është jashtë afatit kohor të lejuar nga dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Komisionerit hetoi ankesat dhe konstatoi se dyqani online u përgjigjet kërkesave për akses, maksimumi, 3 muaj me vonësë në 5% të rasteve. Në total, dyqani kishte marrë rreth 1000 kërkesa për akses në bazë vjetore dhe konfirmoi se 950 prej tyre ishin trajtuar në kohë. Për më tepër, dyqani online kishte miratuar politika për të siguruar që të gjitha kërkesat të trajtoheshin në mënyrë korrekte dhe të plotë. Megjithatë, Zyra e Komisionerit konkludoi se dyqani online kishte shkelur pikën 4, të nenit 12, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave dhe e sanksionoi këtë shkelje me gjobë.

Gjatë përlllogaritjes së masës së sanksionit, Zyra e Komisionerit vlerësoi shkallën e rëndësisë së shkeljes së këtij rasti. Në lidhje me pikënisjen e përlllogaritjes, Zyra e Komisionerit vërejtë se rasti në fjalë rezultonte në shkelje të nenit 12 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, e **cila renditet ndër shkeljet e sanksionueshme sipas pikës 2 të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale**, e cila përbën shkallën më të lartë të masës së sanksionit të parashikuar nga ky nen. Së dyti, Zyra e Komisionerit vlerësoi rrethanat e rastit. Në këtë drejtim, ajo analizoi me kujdes **natyrën e shkeljes**. Edhe pse e drejta për akses në të dhënat personale, brenda afateve të ligjit,



është një nga themelet e të drejtave të subjektit të të dhënave, Zyra e Komisionerit konsideroi se shkelja ishte e një shkalle rëndësie të kufizuar, meqenëse të gjitha kërkesat ishin trajtuar përfundimisht dhe me një vonesë të kufizuar. Duke marrë parasysh **qëllimin e përpunimit**, Zyra e Komisionerit konstatoi se përpunimi i të dhënave personale nuk ishte veprimtaria thelbësore (core activity) i dyqanit online, por gjithsesi një mjet i rëndësishëm ndihmës në përmbushjen e objektivit të tij për shitjen e mallrave online. Zyra e Komisionerit e mori në konsideratë këtë për të ulur shkallën e rëndësisë së shkeljes. Nga ana tjetër, **shkalla e dëmit** të pësuar nga subjektet e të dhënave u konsiderua minimale, pasi të gjitha kërkesat për akses ishin trajtuar brenda 6 muajsh.

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër (natyrën e shkeljes, qëllimin e përpunimit dhe shkallën e dëmit), Zyra e Komisionerit arriti në përfundimin se shkelja rezultoi të jetë e një shkalle të ulët rëndësie. Zyra e Komisionerit përcaktoi si pikënisje për përllogaritjen e masës së sanksionit një vlerë midis 0 dhe 10% të tavanit ligjor të parashikuar në pikën 2, të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4.3 Xhironja e ndërmarrjes si element për vendosjen e një sanksioni efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues

52. Ligji kërkon që Zyra e Komisionerit të sigurojë që sanksioni administrativ (masa e gjobës) të jetë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues në çdo rast individual (neni 93(1) i ligjit). Zbatimi i këtyre parimeve të ligjit mund të ketë pasojë të gjera në raste individuale, pasi pikënisjet që parashikon ligji, në mënyrë abstrakte, për përllogaritjen e masave të sanksioneve zbatohen si për ndërmarrjet e vogla, ashtu edhe ato më të mëdha. Për të aplikuar një sanksion administrativ (gjobë) që është efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues në të gjitha rastet, Zyra e Komisionerit duhet të përshtasë masat e sanksioneve brenda gamës së disponueshme, por pa kaluar tavanin ligjor përkatës. Kjo mund të çojë në zmadhimin ose

zvogëlimin e konsiderueshëm të masës së sanksionit, në varësi të rrethanave të çështjes.

53. Zyra e Komisionerit vlerëson të rëndësishëm përcaktimin e një dallimi të drejtë lidhur me përmasën e kontrolluesve/përpunuesve sa i përket përcaktimit të pikënisjes së përllogaritjes së masave të sanksioneve të treguara në vijim dhe për këtë arsye, merr në konsideratë xhiron e saj¹¹. Megjithatë, kjo nuk e përjashton Zyrën e Komisionerit nga përgjegjësia për të kryer një shqyrtim të efektivitetit, proporcionalitetit dhe karakterit parandalues pas përllogaritjes së masës së sanksionit¹². Kjo e fundit përfshin të gjitha rrethanat e çështjes, si p.sh. kryerja e shkeljeve të shumëfishta, zmadhimin ose dhe zvogëlimin e masës së sanksionit sipas rrethanave rënduese dhe lehtësuese, si dhe sipas rrethanave financiare/socio-ekonomike. Megjithatë, Zyra e Komisionerit duhet të sigurojë që të njëjtat rrethana të mos listohen (merren në konsideratë) dy herë. Në veçanti, Zyra e Komisionerit nuk duhet të përsërisë zmadhimin ose zvogëlimin e masës së sanksionit sipas xhiros së shoqërisë, por të rishikojë vlerësimin e bërë prej saj lidhur me vlerën e përshtatshme të pikënisjes së përllogaritjes.

54. Për arsyet e treguara më sipër, Zyra e Komisionerit mund të marrë në konsideratë përshtatjen e vlerës së pikënisjes së përllogaritjes sipas shkallës së rëndësisë së shkeljes, në rastet kur kjo shkelje kryhet nga një ndërmarrje me një xhiro vjetore jo më shumë se 10 000 000 lekë, një xhiro vjetore jo më shumë se 50 000 000 lekë ose një xhiro vjetore jo më shumë se 250 000 000 lekë¹³.

- Për ndërmarrjet me një xhiro vjetore ≤ 10 000 000 lekë, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë vijimin e përllogaritjes së masës së sanksionit mbi bazën e një shume deri në 0.2% të pikënisjes së identifikuar.

- Për ndërmarrjet me një xhiro vjetore mbi 10 000 000 lekë deri në 50 000 000 lekë, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë vijimin e përllogaritjes së masës së sanksionit mbi bazën e një shume deri në 0.3 % të pikënisjes së identifikuar.

vogla dhe të mesme”, i cili parashikon kategorizimin e ndërmarrjeve, sipas xhiros së tyre, në të vogla, të mesme dhe të mëdha.

¹¹ Xhironja e ndërmarrjes shtjellohet më tej në kapitullin 6.2 të këtij dokumenti.

¹² Shih kapitullin 7.

¹³ Këto vlera i referon dispozitave të ligjit nr. 43/2022, datë 21.4.2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të



- Për ndërmarrjet me një xhiro vjetore mbi 50 000 000 lekë deri 250 000 000 lekë, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë vijimin e përllogaritjes së masës së sanksionit mbi bazën e një shume deri në 5 % të pikënisjes së identifikuar.

55. Për të njëjtat arsye, Zyra e Komisionerit mund të marrë në konsideratë përshtatjen e vlerës së pikënisjes së përllogaritjes sipas shkallës së rëndësisë së shkeljes në rastet kur kjo shkelje kryhet nga një ndërmarrje me një qarkullim vjetor jo më shumë se 500 000 000 lekë, një xhiro vjetore jo më shumë se 1 000 000 000 lekë ose një xhiro vjetore mbi 1 000 000 000 lekë¹⁴.

- Për ndërmarrjet me një xhiro vjetore mbi 250 000 000 lekë deri në 500 000 000 lekë, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë vijimin e përllogaritjes së masës së sanksionit mbi bazën e një shume deri në 8% të pikënisjes së identifikuar.

- Për ndërmarrjet me një xhiro vjetore mbi 500 000 000 lekë deri në 1 000 000 000 lekë, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë vijimin e përllogaritjes së masës së sanksionit mbi bazën e një shume deri në 15% të pikënisjes së identifikuar.

- Për ndërmarrjet me një xhiro vjetore mbi 1 000 000 000 lekë, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë vijimin e përllogaritjes së masës së sanksionit mbi bazën e një shume deri në 40% të pikënisjes së identifikuar.

56. Si rregull i përgjithshëm, sa më i madh të jetë qarkullimi i ndërmarrjes brenda nivelit të zbatueshëm për të, aq më e madhe ka të ngjarë të jetë pikënisja e përllogaritjes. Kjo e fundit vlen veçanërisht për ndërmarrjet më të mëdha, për të cilat kategoria e pikënisjes së përllogaritjes ka gamën më të gjerë.

57. Për më tepër, Zyra e Komisionerit nuk është e detyruar të zbatojë këtë rregullim për të përshtatur pikënisjen e përllogaritjes, nëse kjo nuk paraqitet e nevojshme nga pikëpamja e efektivitetit, proporcionalitetit dhe karakterit parandalues i sanksionit.

58. Duhet të ritheksohet se këto shifra janë pikënisje për llogaritjet e mëtejshme dhe jo shuma fikse (etiketa çmimesh) për shkelje të dispozitave të ligjit për mbrojtje e të dhënave personale. Zyra

e Komisionerit ka diskrecionin për të përdorur gamën e plotë të masave të sanksioneve, nga më minimalja deri në tavanin e zbatueshëm ligjor, duke siguruar që masa e sanksionit të përshtatet me rrethanat e çështjes.

Shembulli 6a. Identifikimi i pikënisjes për përllogaritje të mëtejshme të masës së sanksionit

Një rrjet supermarketesh me një xhiro prej 2 000 000 000 lekësh ka shkelur nenin 12, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave. Zyra e Komisionerit, bazuar në një analizë të kujdesshme të rrethanave të rastit, vendosi se shkelja është e një shkalle rëndësie të ulët. Për të përcaktuar vlerën e pikënisjes për llogaritjen e mëtejshme të masës së sanksionit, Zyra e Komisionerit, fillimisht, vëren se neni 12 i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale renditet në germën "b" të pikës 2 të nenit 94 të ligjit dhe se, bazuar në xhiron e ndërmarrjes (2 000 000 000 lekë), zbatohet një tavan ligjor i barabartë me 2 000 000 000 lekë.

Bazuar në shkallën e rëndësisë së shkeljes, të përcaktuar nga Zyra e Komisionerit (e ulët), pikënisja e përllogaritjes duhet të variojë në vlerat midis 0 dhe 10% të tavanit ligjor të zbatueshëm¹⁵ (pra nga 0 deri në 200 000 000 lekë). Bazuar në xhiron e ndërmarrjes (2 000 000 000 lekë), Zyra e Komisionerit mund të marrë në konsideratë uljen e mëtejshme të kësaj shume në 40% të vlerës së pikënisjes së identifikuar, e cila korrespondon me shkallën e rëndësisë së shkeljes.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit konsideroi se – për shkak të shkallës së rëndësisë relativisht të ulët të shkeljes, krabasuar me xhiron relativisht të madhe të ndërmarrjes – një vlerë pikënisjeje përllogaritje e barabartë me 40 000 000 lekë (që i referohet një vlere pikënisjeje të përllogaritur në vlerën 100 000 000 lekë) konsiderohet efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues. Kjo shumë përbën bazën për përllogaritjen e mëtejshme, e cila duhet të rezultojë në një shumë përfundimtare që nuk e kalon tavanin ligjor të zbatueshëm për këtë rast, të barabartë me 2 000 000 000 lekë.

¹⁴ Këto shifra shtohen për të kapërcyer hendekun midis pragut më të lartë të paragrafit të mëparshëm dhe pragut të

xhiros vjetore të identifikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

¹⁵ Shih paragrafin 49 më sipër.



Shembulli 6b. Identifikimi i pikënisjes për përlogaritje të mëtejshme të masës së sanksionit

Një aplikacion start-up-i, me një xhiro prej 5 000 000 lekësh, zbulohet se ka shitur të dhëna personale sensitive të klientëve të tij te disa ndërmjetës të dhënash për qëllime analitike dhe, në këtë mënyrë, ka shkelur nenet 6(1) dhe 9 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave. Zyra e Komisionerit, bazuar në një analizë të kujdesshme të rrethanave të rastit, vendosi se shkelja është e një shkalle rëndësie të lartë. Për të përcaktuar pikënisjen e përlogaritjes së mëtejshme, Zyra e Komisionerit vëren se nenet 6 dhe 9 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave janë të renditura në nenin 94(2)(a) të tij dhe se, bazuar në xhiron e ndërmarrjes (5 000 000 lekë) zbatohet një tavan ligjor i barabartë me 2 000 000 000 lekë¹⁶.

Bazuar në shkallën e rëndësisë së shkeljes të përcaktuar nga Zyra e Komisionerit (e lartë), pikënisja e përlogaritjes duhet të variojë në vlerat midis 20 dhe 100% të tavanit ligjor të zbatueshëm (pra, midis 400 000 000 dhe 2 000 000 000 lekë tavan¹⁷).

Bazuar në xhiron e ndërmarrjes (5 000 000 lekë), Zyra e Komisionerit mund të marrë në konsideratë uljen e mëtejshme të kësaj shume në 0.2% të vlerës së pikënisjes së identifikuar.

Në rastin konkret (duke iu referuar një vlerë pikënisje të përlogaritur në vlerën 400 000 000 lekë) Zyra e Komisionerit konsideron se –një vlerë pikënisjeje përlogaritje e barabartë me 800 000 lekë konsiderohet efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues. Kjo shumë përbën bazën për përlogaritjen e mëtejshme, e cila duhet të rezultojë në një shumë përfundimtare që nuk e kalon tavanin ligjor të zbatueshëm për këtë rast, të barabartë me 2 000 000 000 lekë.

**KAPITULLI 5
RRETHANAT RËNDUESE DHE
LEHTËSUESE**

5.1 Identifikimi i faktorëve rëndues dhe lehtësues

59. Duke ndjekur strukturën e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi të ketë vlerësuar natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes si dhe karakterin e saj të qëllimshëm (me dashje) ose jo, si dhe kategoritë e të dhënave personale të prekura, Zyra e Komisionerit duhet

të marrë parasysh faktorët e tjerë rëndues ose lehtësues të parashikuar në germën “gj”, të pikës 2, të nenit 93 të ligjit.

60. Për vlerësimin e këtyre elementeve, zmadhimi ose zvogëlimi i masës së një sanksioni nuk mund të paracaktohet nëpërmjet tabelave apo përqindjeve. Vlen të ritheksohet se niveli i sanksionit do të varet nga të gjitha elementet e grumbulluara gjatë hetimit administrativ dhe nga konsiderata të mëtejshme të lidhura edhe me përvojat e mëparshme të aplikimit të sanksioneve administrative (gjobave) nga Zyra e Komisionerit.

61. Për qartësi, duhet theksuar se secili kriter i pikës 2, të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (pavarësisht nëse vlerësohet sipas kapitullit 4 apo këtij kapitulli) – duhet të merret në konsideratë vetëm një herë si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të këtij neni.

5.2 Veprimet e kontrolluesit/përpunuesit në zbutjen e dëmit të pësuar nga subjektet e të dhënave

62. Një hap i parë për të përcaktuar nëse kanë ndodhur rrethana rënduese apo lehtësuese, është shqyrtimi i germës “c” të pikës 2, të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, e cila ka të bëjë me “çdo veprim që kontrolluesi ose përpunuesi ka ndërmarrë për të zbutur dëmin e pësuar nga subjektet e të dhënave”.

63. Kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave janë të detyruar të zbatojnë masa teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun, për të kryer vlerësime të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave dhe për të zbutur rreziqet ndaj të drejtave dhe lirive të individëve, si pasojë e përpunimit të të dhënave personale. Megjithatë, në rast të një shkeljeje, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të bëjë gjithçka mundet për të reduktuar pasojat e shkeljes për individin(ët) përkatës.

64. Marrja e masave të përshtatshme për zbutjen e dëmit të pësuar nga subjektet e të dhënave mund të konsiderohet si një faktor lehtësues, duke zvogëluar, kështu, masën e sanksionit.

65. Masat e marra duhet të vlerësohen, veçanërisht, në lidhje me elementin kohë, d.m.th. kohën kur ato zbatohen nga kontrolluesi ose

¹⁶ Sepse kjo vlerë është me e lartë se 4 % e xhiros së kontrolluesit, e cila përkon me 200 000 000 lekë.

¹⁷ Po aty.



përpunuesi dhe në lidhje me efektivitetin e tyre. Në këtë kuptim, masat e zbatuara spontanisht përpara fillimit të hetimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit kanë më shumë gjasa të konsiderohen si një faktor lehtësues sesa masat që janë zbatuar pas atij momenti (fillimit të hetimit).

5.3 Shkalla e përgjegjësisë së kontrolluesit/përpunuesit

66. Sipas germës “ç” të pikës 2, të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, shkalla e përgjegjësisë së kontrolluesit ose përpunuesit do të duhet të vlerësohet duke marrë parasysh masat e zbatuara prej tyre, në përputhje me nenet 22 dhe 28 të ligjit. Pyetja që më pas duhet t’i përgjigjet Zyra e Komisionerit është se në çfarë mase kontrolluesi bëri atë që mund të pritej të bënte, duke pasur parasysh natyrën, qëllimet ose shtrirjen e përpunimit, porë kjo në dritën e detyrimeve të parashikuara ndaj tyre nga dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

67. Në veçanti, në lidhje me këtë kriter – rreziku i mbetur për liritë dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave – duhet të vlerësohen dëmi i shkaktuar subjekteve të të dhënave dhe dëmi që vazhdon pas marrjes së masave nga kontrolluesi, si dhe shkalla e qëndrueshmërisë së masave të marra në përputhje me nenet 22 dhe 28 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

68. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit mund të marrë në konsideratë, gjithashtu, nëse të dhënat në fjalë janë drejtpërdrejt të identifikueshme dhe/ose të disponueshme pa mbrojtje tekniko-organizative. Megjithatë, duhet pasur parasysh se ekzistenca e një mbrojtjeje të tillë nuk përbën domosdoshmërisht një faktor lehtësues¹⁸. Kjo varet nga të gjitha rrethanat e rastit.

69. Për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme elementet e mësipërme, Zyra e Komisionerit merr parasysh çdo dokumentacion të vënë në dispozicion nga kontrolluesi ose përpunuesi, p.sh. në kuadër të ushtrimit të së drejtës së tyre të mbrojtjes. Në veçanti, një dokumentacion i tillë mund të përmbajë prova se kur janë marrë masat dhe si janë zbatuar ato, nëse ka pasur ndërveprime midis kontrolluesit dhe përpunuesit (nëse është rasti), ose nëse ka pasur kontakt me nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave ose me subjektet e të dhënave (nëse është rasti).

70. Duke konsideruar shkallën e rritur të përgjegjshmërisë sipas nenit 6 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, në krahasim me nenin 5 të ligjit të mëparshëm, mundet që shkalla e përgjegjshmërisë së kontrolluesit ose përpunuesit të konsiderohet një faktor rëndues ose pa ndikim për rastin. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, kur kontrolluesi ose përpunuesi ka shkuar mbi dhe përtej detyrimeve që i ngarkohen, kjo do të konsiderohet një faktor lehtësues.

5.4 Shkeljet e mëparshme të kontrolluesit/përpunuesit

71. Bazuar në germën “d” të pikës 2 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, çdo shkelje e mëparshme e kryer nga kontrolluesi ose përpunuesi duhet të merret parasysh kur vendoset nëse do të vendoset një sanksion dhe kur përcaktohet masa e saj.

5.4.1 Korniza kohore

72. Së pari, duhet t’i kushtohet vëmendje çastit kur ka ndodhur shkelja e mëparshme, duke pasur parasysh se sa më e gjatë të jetë koha midis një shkeljeje të mëparshme dhe shkeljes që është në hetim administrativ, aq më e ulët është rëndësia e saj. Për rrjedhojë, sa më e largët të jetë koha e shkeljes së kryer, aq më pak rëndësi i jepet asaj.

73. Megjithatë, meqenëse shkeljet e kryera shumë kohë më parë mund të jenë ende me interes gjatë vlerësimit të “regjistrave të veprimtarisë së përpunimit” të kontrolluesit ose përpunuesit, nuk duhet të vendosen periudha fikse kufizimi për këtë qëllim.

74. Për të njëjtën arsye, duhet theksuar se shkeljet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke qenë se është ligji i ri në fuqi, duhet të konsiderohen si më të rëndësishme se shkeljet e dispozitave të ligjit të mëparshëm, të shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit aktual.

5.4.2 Çështja

75. Për qëllime të germës “d” të pikës 2 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, shkeljet e mëparshme të të dhënave të një subjekti, të njëjtë ose të ndryshëm me atë që po hetohet, mund të konsiderohen si “të rëndësishme”.

76. Edhe pse të gjitha shkeljet e mëparshme mund të jenë një tregues në lidhje me qëndrimin e përgjithshëm të kontrolluesit ose përpunuesit ndaj respektimit të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e

¹⁸ Shih paragrafin 70, më poshtë.



të dhënave personale, duhet t'u jepet më shumë rëndësi shkeljeve të së njëjtës çështje, pasi ato janë të ngjashme me shkeljen e konstatuar gjatë kohës së hetimit administrativ, veçanërisht kur kontrolluesi ose përpunuesi ka kryer më parë të njëjtën shkelje (shkelje të përsëritura). Kështu, të njëjtat shkelje të çështjes nën hetim duhet të konsiderohen si më të rëndësishme se shkeljet e mëparshme në lidhje me një tematikë tjetër.

77. Për shembull, fakti që kontrolluesi ose përpunuesi kanë dështuar në të kaluarën për t'u përgjigjur, në kohën e duhur, subjekteve të të dhënave, në ushtrimin e të drejtave të tyre, duhet të konsiderohet më i rëndësishëm kur shkelja nën hetim administrativ lidhet, gjithashtu, me mungesën e reagimit/përgjigjes së kontrolluesit ndaj një subjekti të dhënash në ushtrimin e të drejtave të tij, sesa kur i referohet (thjeshtë) një shkeljeje të të dhënave personale.

78. Megjithatë, duhet të merren parasysh edhe shkeljet e mëparshme të një çështjeje tjetër, por që janë kryer në të njëjtën mënyrë, pasi ato mund të jenë tregues i problemeve të vazhdueshme brenda organizatës së kontrolluesit ose përpunuesit. Për shembull, ky do të ishte rasti për shkeljet që lindin si pasojë e mospërfilljes së këshillave/rekomandimeve të nëpunësit përkatës të mbrojtjes së të dhënave.

5.4.3 Vlerësime të tjera

79. Nëse merret në konsideratë një shkelje e kryer gjatë kohës që në fuqi ka qenë ligji i mëparshëm për mbrojtjen e të dhënave, Zyra e Komisionerit mban parasysh faktin që kërkesat/dispozitat e atij ligji mund të ndryshojnë nga ato të ligjit aktual për mbrojtjen e të dhënave personale.

80. Kur shqyrton rëndësinë e një shkeljeje të mëparshme, Zyra e Komisionerit duhet të marrë parasysh statusin e procedurës në të cilën është konstatuar shkelja e mëparshme – veçanërisht çdo masë të marrë nga Zyra e Komisionerit ose nga gjykata – në përputhje me ligjin e mëparshëm.

81. Ekzistenca e shkeljeve të mëparshme mund të konsiderohet si një faktor rëndësues në përllogaritjen e masës së sanksionit. Përkundrazi, faktori duhet të përcaktohet duke pasur parasysh natyrën dhe shpeshtësinë e shkeljeve të mëparshme. Megjithatë, mungesa e ndonjë shkeljeje të mëparshme nuk mund të konsiderohet një faktor lehtësues, pasi respektimi i dispozitave

të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale përbën një normë taksative. Nëse nuk ka shkelje të mëparshme, ky faktor mund të konsiderohet pa ndikim.

5.5 Shkalla e bashkëpunimit me Zyrën e Komisionerit për korrigjimin e shkeljes dhe zbutjen e efekteve negative të saj

82. Germa “dh” e pikës 2 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale kërkon që Zyra e Komisionerit të marrë parasysh shkallën e bashkëpunimit të kontrolluesit ose përpunuesit, në mënyrë që të korrigjohet shkelja përkatës dhe të zbuten efektet e mundshme negative të saj.

83. Përpara vlerësimit të mëtejshëm të shkallës të bashkëpunimit të kontrolluesit ose përpunuesit me Zyrën e Komisionerit, duhet të theksohet fakti se për kontrolluesit/përpunuesit ekziston një detyrim i përgjithshëm për bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit, i parashikuar shprehimisht në nenin 84 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe se mungesa e bashkëpunimit mund të çojë në aplikimin e sanksionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 94 të ligjit. Prandaj duhet mbajtur në konsideratë fakti se bashkëpunimi me Zyrën e Komisionerit, përbën një detyrim të zakonshëm për kontrolluesin/përpunuesin dhe për këtë arsye, duhet të konsiderohet si një faktor pa ndikim (dhe jo si faktor lehtësues) në përllogaritjen e masës së sanksionit.

84. Megjithatë, kur bashkëpunimi me Zyrën e Komisionerit ka pasur efekt në kufizimin ose shmangien e pasojave negative për të drejtat e individëve, Zyra e Komisionerit mund ta konsiderojë këtë si një faktor lehtësues në kuptim të germës “dh” të pikës 2 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke zvogëluar, kështu, masën e sanksionit. Ky mund të jetë, p.sh., rasti kur një kontrollues ose përpunues u është përgjigjur në një mënyrë të veçantë kërkesave të Zyrës së Komisionerit, gjatë fazës së hetimit administrativ, gjë që ka sjellë si rezultat, më pas, kufizimin e ndjeshëm të ndikimit negativ, në të drejtat e individëve.

5.6 Mënyra sesi shkelja i është bërë e ditur Zyrës së Komisionerit

85. Bazuar në germën “e” të pikës 2 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyra në të cilën Zyra e Komisionerit është vënë në dijeni për shkeljen mund të përbëjë një faktor



rëndues ose lehtësues për përlogaritjen e masës së sanksionit. Në vlerësimin e kësaj çështjeje, një peshë të veçantë mund të marrë pyetja nëse, si dhe në çfarë mase, kontrolluesi ose përpunuesi ka njoftuar Zyrën e Komisionerit për shkeljen me iniciativë të tij, përpara se shkelja t'i bëhet e ditur Zyrës së Komisionerit në rrugë të tjera (p.sh., nëpërmjet një ankese nga subjekti i të dhënave, ose një hetimi administrativ të nisur *ex officio*). Kjo rrethanë nuk paraqet rëndësi kur kontrolluesi i nënshtrohet detyrimit specifik për njoftim (si, p.sh., në rastin e shkeljeve të të dhënave personale sipas nenit 29, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale¹⁹). Në këto raste, njoftimi duhet të konsiderohet si faktor pa ndikim.

86. Kur shkelja i bëhet e ditur Zyrës së Komisionerit, p.sh., me një ankesë ose gjatë një hetimi administrativ kryesisht, ky element duhet gjithashtu, si rregull, të konsiderohet si faktor pa ndikim. Zyra e Komisionerit mund ta konsiderojë si rrethanë lehtësuese, rastin kur kontrolluesi ose përpunuesi e ka njoftuar shkeljen me iniciativën e tij, përpara se Zyra e Komisionerit të marrë dijeni për rastin.

5.7 Përputhshmëria me detyrat e lëna më herët për të njëjtën çështje

87. Germa “f” e pikës 2 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale parashikon se “*zbatimi i masave korrigjuese, kur përpara shkeljes këto masa janë dhënë ndaj kontrolluesit ose përpunuesit në lidhje me të njëjtën çështje*” duhet të merret parasysh në vlerësimin nëse ndaj kontrolluesit/përpunuesit do të vendoset sanksioni administrativ gjobë, si dhe në përcaktimin e masës së saj.

88. Përkundër germës “d” të pikës 2 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ky vlerësim i referohet vetëm detyrave korrigjuese që vetë Zyra e Komisionerit i ka lënë, më herët, të njëjtut kontrollues ose përpunues në lidhje me të njëjtën çështje.

89. Në këtë kuadër, kontrolluesi ose përpunuesi mund të ketë pritshmëri, të arsyeshme, që respektimi i detyrave të lëna për të, më herët, do të mund të parandalonte ndodhjen/përsëritjen e shkeljes të së njëjtës natyrë në të ardhmen. Megjithatë, meqenëse përmbushja e detyrave të

lëna, më herët, nga Zyra e Komisionerit është e detyrueshme për kontrolluesin ose përpunuesin, ky element nuk duhet të merret parasysh si një faktor lehtësues në vetvete. Përkundrazi, kërkohet një angazhim i shtuar nga ana e kontrolluesit ose përpunuesit në përmbushjen e detyrave të lëna, në mënyrë që ky element të konsiderohet si faktor lehtësues në përlogaritjen e masës së sanksionit (p.sh., marrja e masave shtesë, përtej atyre të urdhëruara nga Zyra e Komisionerit).

90. Në të kundërt, mosrespektimi i një mase korrigjuese të urdhëruar më herët nga Zyra e Komisionerit, mund të konsiderohet ose si një faktor rëndues, ose si një shkelje e ndryshme/e re në vetvete, bazuar në pikën 3 të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Prandaj, duhet pasur parasysh se e njëjta sjellje, nuk mund të shpjërohet në një situatë ku të sanksionohet administrativisht (me gjobë) dy herë.

5.8 Respektimi i kodeve të miratuara të sjelljes dhe/ose mekanizmave të miratuar të certifikimit

91. Germa “g” e pikës 2 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, thekson se respektimi i kodeve të sjelljes, në përputhje me nenin 35, ose i mekanizmave të miratuar të certifikimit, në përputhje me nenin 37 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të jetë një faktor i rëndësishëm në vlerësimin nëse ndaj kontrolluesit/përpunuesit do të vendoset sanksioni administrativ gjobë, si dhe në përcaktimin e masës së saj.

92. Respektimi i kodeve të sjelljes, ose mekanizmave të miratuar të certifikimit në përputhje përkatësisht me nenet 35 dhe 37 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të përbëjë një faktor lehtësues në përlogaritjen e masës së sanksionit²⁰.

93. Nga ana tjetër, nëse mosrespektimi i kodeve të sjelljes, ose i certifikimit, lidhet drejtpërdrejt me shkeljen e konstatuar, Zyra e Komisionerit mund ta konsiderojë këtë si një rrethanë rënduese në përlogaritjen e masës së sanksionit.

¹⁹ Duhet theksuar se një cenim të dhënash personale (*data breach*), jo gjithnjë nënkupton një shkelje të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

²⁰ Ky është edhe qëndrimi i BEMD-së, i shprehur, ndër të tjera, në udhëzimet e Grupit të Punës 235 (*WP235*).



5.9 Rrethana të tjera rënduese dhe lehtësuese

94. Germa “gj” e pikës 2 të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, i jep Zyrës së Komisionerit një hapësirë diskrecionale, për të marrë parasysh çdo faktor tjetër rëndues ose lehtësues të zbatueshëm për rrethanat e çështjes. Në një çështje individuale mund të ketë shumë elemente të përfshira (të cilët nuk mund të listohen të gjithë në mënyrë shteruese), që duhet të merren parasysh në mënyrë që të sigurohet që masa e sanksionit të vendosur të jetë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues, në çdo rast.

95. Germa “gj” e pikës 2, të nenit 93, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, përmend shembuj të rrethanave rënduese ose lehtësuese që lidhet me rrethanat e çështjes, si p.sh. përfitimet financiare ose humbjet e shmangura, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga shkelja. Kjo dispozitë ka rëndësi themelore për përshtatjen e masës së sanksionit në rastin konkret. Në këtë kuptim, kjo dispozitë duhet interpretuar si shembull i parimit të trajtimit të ndershëm dhe drejtë të çështjes përkatëse.

96. Objekti i kësaj dispozite, i cili është domosdoshmërisht joshterues, duhet të përfshijë të gjitha rrethanat e arsyetuara në lidhje me kontekstin social-ekonomik në të cilin operon kontrolluesi ose përpunuesi, si dhe ato që lidhen me kontekstin ligjor dhe ato që kanë të bëjnë me kontekstin e tregut.

97. Në veçanti, përfitimi ekonomik nga shkelja mund të jetë një rrethanë rënduese, nëse nga çështja rezulton se kontrolluesi/përpunuesi ka nxjerrë përfitim si rezultat i shkeljes së ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

98. Rrethanat e jashtëzakonshme që mund të çojnë në ndryshime të rëndësishme në kontekstin social-ekonomik (p.sh. fillimi i një emergjence të rëndë pandemike, që mund të ndryshojë rrënjësisht mënyrën sesi kryhet përpunimi i të dhënave personale), mund të merret, gjithashtu, në konsideratë bazuar në germën “gj” të pikës 2 të

nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Shembujt në këtë kapitull janë ilustrime të efektit që mund të kenë rrethanat rënduese dhe lehtësuese në përllogaritjen e masës së sanksionit. Zmadhimet ose zvogëlimet e përmendura në këto çështje hipotetike nuk mund të konsiderohen si precedentë apo tregues të përqindjeve që do të përdoren në realitet.

Shembulli 7a. Vlerësimi i rrethanave rënduese dhe lehtësuese

Një klub sportiv përdorte kamera të pajisura me teknologjinë e njohjes së fytyrës në hyrje të një prej vendndodhjeve të tij, për të identifikuar klientët përkatës që në hyrje. Megjithatë klubi sportiv e kryente këtë përpunim në kundërshtim me nenin 9 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (përpunimi i të dhënave biometrike, pa një kriter ligjor të vlefshëm), Zyra e Komisionerit, pasi betoi shkeljen, vendosi të aplikonte një sanksion administrativ gjorbë. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse të çështjes, Zyra e Komisionerit e konsideroi këtë si shkelje me shkallë të lartë rëndësie dhe, meqenëse klubi sportiv kishte një xhiro vjetore të barabartë me 700 000 000 lekë, pikënisja e përllogaritjes duhet të variojë midis 20 dhe 100% të tavanit ligjor të zbatueshëm (pra, në vlerat midis 400 000 000 dhe 2 000 000 000 lekë). Bazuar në xhiron e kontrolluesit (700 000 000 lekë), Zyra e Komisionerit mori në konsideratë uljen e mëtejshme të kësaj shume në 15% të vlerës së pikënisjes së identifikuar²¹.

Megjithatë, duke qenë se i njëjti klub sportiv ishte gjobitur dy vjet më herët për përdorimin e teknologjisë së përpunimit të shenjave daktiloskopike në hyrje të një vendndodhjeje tjetër të tij, Zyra e Komisionerit vendosi ta marrë parasysh këtë si një shkelje të përsëritur (neni 93(2)(d) i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale). Duke vepruar kështu, Zyra e Komisionerit i dha rëndësi faktit se kjo kishte të bënte pothuajse me të njëjtën tematikë dhe shkelja ishte kryer vetëm dy vjet më parë. Për shkak të këtij faktori rëndues, Zyra e Komisionerit vendosi të zmadhojë masën e sanksionit, për këtë çështje specifike, në vlerën 124 800 000 lekë²², duke mos e

²¹ Duke vlerësuar rrethanat e rastit, është marrë si vlerë pikënisje për përllogaritjen e mëtejshme të sanksionit, vlera prej 800 000 000 lekësh.

²² Kjo ilustron faktin se kategoritë e pikënisjeve të përllogaritjes së masës së sanksionit nuk i kufizojnë aftësitë

e Zyrës së Komisionerit për të marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese në vendosjen e një sanksioni më të lartë ose më të ulët se kategoritë në fjalë. Siç theksohet në kapitullin 4, këto shifra përbëjnë pikënisje për përllogaritjen e mëtejshme të masës së sanksionit dhe jo vlera fikse (etiketa



tejkualuar tavanin ligjor në fuqi prej 2 000 000 000 lekësh.

Shembulli 7b. Vlerësimi i rrethanave rënduese dhe lehtësuese

Operatori i një platforme të marrjes me qira të automjeteve pësoi një cenim të dhënash (data breach), duke bërë që të dhënat personale të klientëve të tij të ekspozoheshin ndaj cenimeve, për një kohë të shkurtër. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse të çështjes, Zyra e Komisionerit vlerësoi mangësitë e operatorit, për të marrë masa tekniko-organizative për garantimin e sigurisë së platformës së tij, si shkelje të nenit 28 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, si shkelje të një shkalle rëndësie të ulët. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit përcaktoi si pikënisje për përllogaritjen e masës së sanksionit një vlerë midis 0 dhe 10% të tavanit ligjor të parashikuar në pikën 1(a) të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (pra, 0 deri në 100 000 000 lekë). Bazuar në xhiron e Kontrolluesit (1 100 000 000 lekë), Zyra e Komisionerit mund të merrte në konsideratë uljen e mëtejshme të kësaj shume në 40% të vlerës së pikënisjes së identifikuar²³. Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerësoi si të përshtatshme aplikimin e një pikënisjeje për përllogaritjen e mëtejshme të sanksionit në vlerën e e barabartë me 32 000 000 lekë.

Të dhënat personale të komprometuara përfshinin kopje të lejeve të drejtimit dhe letërnjoftimeve elektronike. Për këtë arsye, të gjithë klientët që u cenuan nga shkelja e të dhënave (data breach) u detyruan të riaplikonin për këto dokumente, për të kufizuar mundësinë e vjedhjes së identitetit përkatës në të ardhmen. Gjatë informimit të subjekteve të të dhënave për këtë incident, operatori u ofroi të gjithë subjekteve të të dhënave ndihmë për të riaplikuar për këto dokumente pranë institucioneve publike dhe krijoi një sistem për rimbursimin e çdo tarife të paguar për aplikim. Zyra e Komisionerit e konsideroi këtë si veprim për të zbutur

dëmin e pësuar nga subjektet e të dhënave (neni 93(2)(c) i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale), i cili pati një efekt lehtësues për sanksionin. Nisur nga qëndrimi proaktiv dhe efektiviteti i masave të marra nga operatori, Zyra e Komisionerit vendosi ta zbrisë sanksionin në 16 000 000 lekë (sërish duke mos tejkualuar tavanin ligjor prej 1 000 000 000 lekësh).²⁴

Shembulli 7c. Vlerësimi i rrethanave rënduese dhe lehtësuese

Një agjenci e vogël e vlerësimi kredish u zbulua se kishte shkelur disa dispozita që mbronin të drejtat e subjekteve të të dhënave, më së shumti sepse u ngarkonte klientëve të saj një tarifë për ushtrimin e të drejtës së tyre për akses. Agjencia e bënte këtë për të gjitha kërkesat për akses. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, Zyra e Komisionerit vlerësoi se shkeljet e konstatuara ishin të një shkalle rëndësie të lartë. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit përcaktoi si pikënisje për përllogaritjen e masës së sanksionit një vlerë midis 20% dhe 100% të tavanit ligjor të parashikuar në pikën 2(b) të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (pra, 400 000 000 deri në 2 000 000 000 lekë). Meqenëse agjencia kishte një xhiro vjetore prej 30 000 000 lekësh, Zyra vlerësoi si të përshtatshme aplikimin e një pikënisjeje për përllogaritjen e mëtejshme të sanksionit në vlerën e barabartë me 2 400 000 lekë (nisur nga përmasa e Kontrolluesit, pikënisja për përllogaritjen e sanksionit reduktohet në 0.3% të vlerës së pikënisjes së mësipërme).²⁵

Megjithatë, Zyra e Komisionerit mori në konsideratë faktin se agjencia kishte qenë në gjendje të përfitonte financiarisht nga shkelja, e cila përbënte një rrethanë rënduese (neni 93(2)(g) i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale). Me synimin për të kundërbalancuar përfitimet nga shkelja, duke ruajtur një ndikim efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues të masës së sanksionit për këtë çështje, Zyra e Komisionerit vendosi të zmadhojë masën e sanksionit në 30 000 000 lekë,

çmimesh) për shkelje të dispozitave të ligjit. Zyra e Komisionerit ka diskrecion për të shfrytëzuar gamën e plotë të sanksioneve, nga një lekë deri në tavanin e parashikuar ligjor, duke siguruar që masa e sanksionit të përshtatet me rrethanat e çështjes.

²³ Duke vlerësuar rrethanat e rastit (xhiron e ndërmarrjes dhe rëndësinë e shkeljes) është marrë si vlerë pikënisjeje për përllogaritjen e mëtejshme të sanksionit, vlera prej 80 000 000 lekësh.

²⁴ Nga vlera prej 32 000 000 lekësh (e dalë si rezultat i përshtatjes me 40% të vlerës së pikënisjes së identifikuar prej 80 000 000 lekësh) është hequr vlera prej 50%, duke

vlerësuar sjelljen proaktive për zbutjen e dëmit. Ky shembull ka vetëm qëllim ilustrues dhe nuk nënkupton që qasja e komisionerit do të jetë në çdo rast e tillë. Zyra e Komisionerit mund të çmojë dhe uljen me 2, 4 ose vetëm 5 % të vlerës 32 000 000 lekë.

²⁵ Është marrë si vlerë pikënisjeje për përshtatjen e sanksionit në varësi të xhiros së ndërmarrjes vlera minimale prej 800 000 000 lekësh, e cila është përshtatur më tej me vlerën 0.3% sipas parashikimit për xhiron.



duke mos e tejkaluar tavanin ligjor prej 2 000 000 000 lekësh.

Shembulli 7d. Vlerësimi i rrethanave rënduese dhe lehtësuese

Një shoqëri tregtare rezultoi se kishte shkelur dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht për shkak të shitjes së bazës së të dhënave të saj për publicitet tregtar të partnerët e saj, e cila përmbante të dhëna personale në lidhje me qytetarë që nuk kishin dhënë pëlqimin e tyre për këtë qëllim.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse të çështjes, Zyra e Komisionerit i konsideroi shkeljet e konstatuara si të një shkalle të mesme rëndësie dhe përcaktoi si pikënisje për përllogaritjen e masës së sanksionit një vlerë midis 10% dhe 20% të tavanit ligjor të parashikuar në pikën 2(a) të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (pra, 200 000 000 deri në 400 000 000 lekë).

Megjithatë shoqëria në fjalë kishte një xhiro vjetore prej 40 000 000 lekësh, u vlerësua i përshtatshëm reduktimi i pikënisjes së përllogaritjes në një vlerë prej 0,3% të diapazonit të pikënisjes së mësipërme. Për këtë arsye, u çmua aplikimi i një pikënisjeje për përllogaritjen e mëtejshme të sanksionit në vlerën e barabartë me 900 000 lekë.²⁶

Më tej, Zyra e Komisionerit vlerësoi se kjo ishte një shkelje nga e cila kishte përfituar kontrolluesi, sepse fakti i mosmarrjes së pëlqimit të qytetarëve për transmetimin e të dhënave të tyre të partnerët e shoqërisë, me qëllim të dërgimit të reklamave përkatëse, kishte rritur sasinë e të dhënave që kontrolluesi kishte mundur të rishiste më pas. Prandaj, Zyra e Komisionerit e konsideroi faktin që kontrolluesi ishte në gjendje të përfitonte nga shkelja, si një rrethanë rënduese (neni 93 (2)(g) i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale).

Me qëllim kundër balancimit të përfitimeve nga shkelja, duke ruajtur një ndikim efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues të sanksionit, Zyra e Komisionerit vendosi të zmadhojë masën e sanksionit në 1 200 000 lekë, duke mos e tejkaluar tavanin ligjor të zbatueshëm prej 2 000 000 000 lekësh.

KAPITULLI 6 TAVANI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSIA KORPORATIVE

6.1 Përcaktimi i tavanit ligjor

99. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk parashikon masa fikse sanksionesh për shkelje specifike. Në vend të kësaj, ligji parashikon tavane ligjore të përgjithshme.

100. Masat e sanksioneve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale janë tavane ligjore, të cilat nuk lejojnë vendosjen e sanksioneve në tejkallim të këtyre vlerave. Për të përcaktuar tavanin e saktë ligjor, duhet marrë në konsideratë pika 3 e nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, aty ku është e zbatueshme²⁷. Prandaj, Zyra e Komisionerit është e detyruar të sigurojë që këto tavane ligjore të mos tejkalohen gjatë përllogaritjes së masave të sanksioneve bazuar në këtë metodologji. Në varësi të rastit individual, mund të zbatohen tavane ligjore të ndryshme.

6.1.1 Tavanet ligjore statike

101. Neni 94 i ligjit për mbrojtjen e të dhënave parashikon tavane statike dhe bën dallimin midis shkeljeve të kategorive të ndryshme të detyrimeve të dispozitave të ligjit. Siç shpjegohet më sipër në këtë dokument, pika 1 e nenit 94, përcakton një tavan ligjor deri në 1 000 000 000 lekë për shkelje të detyrimeve të përshkruara në të, ndërsa pikat 2 dhe 3 i të njëjtit nen përcaktojnë sanksione deri në 2 000 000 000 lekë për shkeljen e detyrimeve të përshkruara në to.

6.1.2 Tavanet ligjore dinamike

102. Në rastin e një ndërmarrjeje²⁸, diapazoni i sanksioneve mund të zhvendoset drejt një tavanit ligjor më të lartë të bazuar në xhiron vjetore²⁹. Ky tavan ligjor i bazuar në xhiron e ndërmarrjes është dinamik dhe i individualizueshëm për një ndërmarrje (kontrollues/përpunues) të caktuar, në përputhje me parimet e efektivitetit, proporcionalitetit dhe me karakter parandalues të masës së sanksionit.

103. Më konkretisht, pika 1 e nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale lejon një

²⁶ Është marrë si vlerë pikënisjeje për përshtatjen e sanksionit në varësi të xhiros së ndërmarrjes vlera minimale prej 300 000 000 lekësh, e cila është përshtatur më tej me vlerën 0.3 % sipas parashikimit për xhiron.

²⁷ Shih nënkaptullin 3.1.2.

²⁸ Shih nënkaptullin 6.2.1 të kësaj metodologjie në lidhje me termin “ndërmarrje”.

²⁹ Shih nënkaptullin 6.2.2 të kësaj metodologjie në lidhje me termin “xhiro”.



tavan ligjor deri në 2% të xhiros vjetore globale, ndërsa pikat 2 dhe 3 të këtij neni parashikojnë një tavan ligjor deri në 4 % të xhiros vjetore globale (në të dyja rastet xhiroja globale referente është ajo e vitit të shkuar financiar të ndërmarrjes). Parashikimet ligjore kërkojnë marrjen në konsideratë të tavanit ligjor statik ose atij dinamik të bazuar në xhiron vjetore globale të ndërmarrjes dhe urdhëron aplikimin e vlerës më të lartë midis tyre (“cilado është më e lartë”). Rrjedhimisht, tavanet ligjore të bazuara në xhiron vjetore janë të zbatueshme vetëm nëse tejkalojnë tavanin statik në një çështje të caktuar. Ky është rasti kur xhiroja vjetore globale e ndërmarrjes për vitin e kaluar financiar është më shumë se 50 000 000 000 lekë³⁰.

Shembulli 8a. Tavan ligjor dinamik

Një agjenci raportimi kredish (CRA) mbledh dhe shet të gjitha të dhënat e aftësisë kredishlyerëse të të gjithë qytetarëve shqiptarë të shoqëritë e marketingut dhe shitjes me pakicë, pa pasur asnjë bazë ligjore për këtë. Xhiroja vjetore globale e agjencisë gjatë vitit të kaluar arrin në 80 000 000 000 lekë. Në këtë rast, agjencia ka shkelur, ndër të tjera, nenin 7 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, shkelje e cila është e dënueshme me sanksion bazuar në pikën 2 të nenit 94 të ligjit. Tavan ligjor statik do të arrinte në 2 000 000 000 lekë. Tavan ligjor dinamik do të arrinte në 3 200 000 000 lekë (4% e xhiros 80 000 000 000 lekë). Masa e sanksionit mund të arrijë deri në 3 200 000 000 lekë, pasi ky tavan ligjor dinamik është më i lartë se tavan ligjor statik prej 2 000 000 000 lekësh. Si pasojë, sanksioni lejohet të kalojë tavanin ligjor statik prej 2 000 000 000 lekësh, por nuk duhet të kalojë tavanin ligjor dinamik prej 3 200 000 000 lekësh.

Shembulli 8b. Tavan ligjor statik

Një shitës me pakicë i syzeve të diellit operon një dyqan online, i cili i lejon klientët të bëjnë porositë e tyre online. Me anë të formularit të porosisë, shitësi me pakicë përpunon edhe të dhëna personale, duke përfshirë të dhënat e llogarisë bankare. Shitësi me pakicë nuk siguron një enkriptim të duhur transmetimi online (https), duke bërë që palët e treta të jenë potencialisht në gjendje të interceptojnë të dhënat personale gjatë transaksionit. Shitësi me pakicë shkel nenin 28 (1) të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mund të jetë subjekt për t'u sanksionuar bazuar në pikën 1 të

nenit 94 të ligjit. Xhiroja vjetore globale e shitësit me pakicë për vitin e kaluar arrin në 40 000 000 000 lekë. Në këtë rast, tavan ligjor statik prej 1 000 000 000 lekësh është më i lartë se tavan ligjor dinamik prej 800 000 000 lekë (=2% e xhiros prej 40 000 000 000 lekësh), kështu që tavan ligjor statik mbizotëron. Prandaj, masa e sanksionit, në këtë rast, nuk duhet të tejkalojë tavanin ligjor prej 1 000 000 000 lekësh.

Shembulli 8c. Kontrolluesit dhe përpunuesit që nuk janë ndërmarrje

Një bashki ka një sistem online që u lejon qytetarëve të saj të regjistrohen për shërbime, të tilla si ato të aplikimeve për pasaportë ose celebrim martesor. Bashkia është kontrolluesi i vetëm për këtë sistem online. Për fat të keq, është konstatuar se sistemi, gjithashtu, transmeton, në mënyrë të përhershme, të dhënat e mbledhura në serverët e jashtëm të një përpunuesi të vendosur në një shtet pa nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave, ku ato ruhen. Në këtë rast, nuk janë marrë masa tekniko-organizative të përshtatshme në lidhje me transferimin e shtetit në fjalë. Përveç transferimit, të dhënat mbledhen dhe përpunohen në bazë të pëlqimit të vlefshëm. Bashkia ka shkelur nenin 41 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke transferuar kategori të veçanta të të dhënave personale në një vend të tretë, pa nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale, pa garancitë e nevojshme/një kriter të ligjshëm për këtë qëllim. Prandaj, bashkia në fjalë mund të sanksionohet në përputhje me pikën 2, të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave. Megjithatë bashkia nuk përfshihet në përkufizimin e ndërmarrjes, në këtë rast është i zbatueshëm tavan ligjor statik dhe, rrjedhimisht, masa e sanksionit nuk duhet të kalojë vlerën 2 000 000 000 lekë.

6.2 Përcaktimi i xhiros së ndërmarrjes dhe përgjegjësia korporative

104. Për të përcaktuar xhiron e saktë për tavanin ligjor dinamik, është e rëndësishme të kuptohen konceptet e “ndërmarrjes” dhe “xhiros” siç artikuloohen në nenin 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

6.2.1 Përcaktimi i një ndërmarrjeje dhe përgjegjësia korporative

105. Bazuar në jurisprudencën e BE-së, termi “ndërmarrje” përfshin çdo entitet të angazhuar në

lekë) i nenit 94 të ligjit është i barabartë me tavanin ligjor dinamik (4% e xhiros globale) të këtij neni.

³⁰ Në rastin e një xhiroje vjetore të barabartë me 50 000 000 000 lekë, tavan ligjor statik maksimal (2 000 000 000 lekë) Faqe| 19234



një veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit ligjor të këtij entiteti dhe mënyrës në të cilën ai financohet³¹. Rrjedhimisht, “ndërmarrjet” identifikohen si njësi ekonomike, në vend të njësive ligjore (subjekte me personalitet të veçantë juridik). Shoqëri të ndryshme që i përkasin të njëjtit grup shoqërisht mund të formojnë një njësi ekonomike dhe, për rrjedhojë, një ndërmarrje.

106. Rrjedhimisht, termi “ndërmarrje” mund t’i referohet një njësie të vetme ekonomike (NJVE), edhe nëse ajo njësi ekonomike përbëhet nga disa persona fizikë ose juridikë. Të formuarit e një NJVE nga disa subjekte varet, kryesisht, nga fakti nëse NJVE është e lirë në aftësinë e saj vendimmarrëse ose nëse një njësi ekonomike drejtuese, domethënë shoqëria mëmë, ushtron ndikim vendimtar mbi të tjerët. Kriteret për përcaktimin e këtij ndikimi bazohen në lidhjet ekonomike, ligjore dhe organizative ndërmjet shoqërisë mëmë dhe të kontrolluarës së saj (p.sh., shkalla e pjesëmarrjes, lidhjet e personelit ose ato organizative, udhëzimet dhe ekzistenca e kontratave të shoqërisë)³².

107. Në përputhje me doktrinën e NJVE-së, neni 94 i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ndjek parimin e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë korporative, i cili nënkupton se të gjitha veprimet e kryera ose të neglizhuara nga persona fizikë të autorizuar për të vepruar në emër të ndërmarrjes i atribuohen kësaj të fundit dhe konsiderohen si një veprim dhe shkelje e kryer drejtpërdrejt nga vetë ndërmarrja. Fakti që disa punonjës nuk respektojnë një kod sjelljeje nuk mjafton për të evituar këtë atribuim përgjegjësie. Përkundrazi, përgjegjësia përjashtohet vetëm kur personi fizik vepron për qëllimet e tij private/personale ose për qëllimet e një pale të tretë, duke u kthyer, kështu, vetë në një kontrollues të veçantë (d.m.th. personi fizik ka vepruar përtej kompetencave që i janë akorduar atij).

108. Në rastin kur një shoqëria mëmë zotëron 100% ose pothuajse 100% të aksioneve/kapitalit të një shoqërie të kontrolluar, do të prezumohet

se shoqëria mëmë është në gjendje të ushtrojë ndikim vendimtar mbi sjelljen e shoqërisë së kontrolluar. Kjo vlen edhe nëse shoqëria mëmë nuk zotëron drejtpërdrejt aksionet/kapitalin total direkt, por në mënyrë indirekte nëpërmjet një ose më shumë shoqërisht të kontrolluara. Në këto rrethana, mjafton që Zyra e Komisionerit të provojë se shoqëria e kontrolluar është drejtpërdrejt ose tërthorazi, tërësisht ose pothuajse tërësisht në pronësi të shoqërisë mëmë për të dalë në përfundimin se shoqëria mëmë ushtron një ndikim vendimtar.

109. Megjithatë, supozimi i pasqyruar më sipër nuk është absolut, por mund të kundërshtohet me prova të tjera. Për të hedhur poshtë supozimin në fjalë, shoqëria duhet të ofrojë prova sa i përket lidhjeve organizative, ekonomike dhe ligjore midis shoqërisë së kontrolluar dhe shoqërisë mëmë, të cilat janë të përshtatshme për të demonstruar se ato nuk përbëjnë një NJVE, pavarësisht se shoqëria mëmë zotëron 100% ose pothuajse 100 % të kapitalit të shoqërisë së kontrolluar. Për të përcaktuar nëse një shoqëri e kontrolluar vepron në mënyrë autonome, duhet të merren parasysh të gjithë faktorët përkatës që kanë të bëjnë me ato lidhje që lidhin shoqërinë e kontrolluar me shoqërinë mëmë, të cilat mund të ndryshojnë rast pas rasti dhe, për këtë arsye, nuk mund të përcaktohen në një listë shteruese.

110. Nëse, nga ana tjetër, shoqëria mëmë nuk zotëron të gjithë ose pothuajse të gjithë kapitalin e shoqërisë së kontrolluar, duhet të evidentohen fakte shtesë për të justifikuar ekzistencën e një NJVE. Në këtë rast, nevojitet të demonstronhet, jo vetëm që shoqëria mëmë ka aftësinë për të ushtruar ndikim vendimtar mbi shoqërinë e kontrolluar, por, gjithashtu, se ajo ka ushtruar në të vërtetë një ndikim të tillë vendimtar, në mënyrë që të mund të ndërhyjë në çdo kohë në lirinë e zgjedhjes së shoqërisë së kontrolluar dhe të përcaktojë sjelljen e saj.

111. Sanksioni i drejtohet (bashkë) kontrolluesit/përpunuesit dhe Zyra e Komisionerit ka mundësinë ta konsiderojë

³¹ Shih jurisprudencën e BE-së; çështja C-41/90, *Höfner dhe Elser kundër Macrotron GmbH*, paragrafi 21; çështjet e përbashkëta (*joined cases*) C-159 dhe 160/91, *Poucet dhe Pistre kundër Assurances Générales de France*, paragrafi 17; çështja 364/92, *SAT Fluggesellschaft mbH kundër Eurocontrol*, paragrafi 18; çështjet e përbashkëta (*joined cases*) C-180-184/98, *Pavlov*

dhe të tjerët, paragrafi 74; çështja C-138/11, *Compass-Datenbank GmbH kundër Republikës së Austrisë*, paragrafi 35.

³² Çështja C-90/09 P, *General Química and Others kundër Komisionit*.



shoqërinë mëmë, solidarisht dhe individualisht përgjegjëse për pagesën e sanksionit.

6.2.2 Përcaktimi i xhiros

112. Xhiroja nxirret nga pasqyrat financiare vjetore të një ndërmarrjeje (konkretisht nga pasqyra e “humbjeve dhe fitimeve”), të cilat japin një pasqyrë të vitit të kaluar financiar të një shoqërie ose të një grupi shoqërisht (pasqyrat financiare të konsoliduara). Xhiroja në kuptim të nenit 94 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave duhet të kuptohet si xhiro neto, e cila nënkupton vlerën që rrjedh nga shitja e mallrave/shërbimeve, pas zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksave të tjera të lidhura drejtpërdrejt me xhiron. Nuk përfshihen në këtë xhiro, të ardhurat që vijnë nga transaksione sporadike, të cilat nuk lidhen me objektin e veprimtarisë së ndërmarrjes.

113. Nëse ndërmarrja i nënshtrohet detyrimit të përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, këto pasqyra financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë, që kryeson grupin, janë të rëndësishme për pasqyrimin e xhiros të kombinuar (globale) të ndërmarrjes. Nëse nuk ekzistojnë pasqyra të tilla, do të merret dhe përdoret çdo dokument tjetër që është i përshtatshëm për të konstatuar xhiron vjetore globale të ndërmarrjes për vitin përkatës financiar.

KAPITULLI 7

EFEKTIVITETI, PROPORCIONALITETI DHE KARAKTERI PARANDALUES

114. Sanksioni i vendosur për shkeljet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale duhet jetë efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues për çdo çështje individuale. Me fjalë të tjera, masa e sanksionit të vendosur duhet t'i përshtatet shkeljes së kryer në kontekstin e saj specifik.

115. Siç shpjegohet në kapitullin 4, vlerësimi i kryer në këtë kapitull mbulon tërësinë e sanksionit të vënë dhe të gjitha rrethanat e çështjes, duke përfshirë p.sh. akumulimin e shkeljeve të shumta, zmadhimet dhe zvogëlimet sipas rrethanave rënduese dhe lehtësuese dhe rrethanat financiare/socio-ekonomike.

7.1 Efektiviteti

116. Në përgjithësi, sanksioni mund të konsiderohet efektiv nëse arrin objektivat në bazë të të cilëve është vendosur (qoftë kjo për të

rivendosur përputhshmërinë me rregullat, qoftë për të ndëshkuar sjelljen e paligjshme, ose të dyja).

117. Siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 93 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit duhet të vlerësojë efektivitetin e sanksionit në çdo rast individual. Për këtë qëllim, duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur rrethanave të çështjes dhe në veçanti, vlerësimit të bërë më sipër, duke pasur parasysh se sanksioni duhet të jetë gjithashtu proporcional dhe me karakter parandalues, siç përshkruhet më poshtë.

7.2 Proporcionaliteti

118. Parimi i proporcionalitetit kërkon që masat e marra të mos kalojnë kufijtë e asaj që është e përshtatshme dhe e nevojshme për të arritur objektivat e ndjekur në mënyrë legjitime nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave. Kur ka një zgjedhje midis disa masave të përshtatshme, duhen konsideruar ato më pak rënduese dhe disavantazhet e shkaktuara nuk duhet të jenë joproporcionale me qëllimet e ndjekura.

119. Nga kjo rrjedh se sanksionet nuk duhet të jenë në disproporcion me qëllimet e ndjekura (d.m.th. respektimi i rregullave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të personave fizikë), si dhe se masa e sanksionit të vendosur duhet të jetë në përpjesëtim me shkeljen, duke marrë parasysh, në veçanti, shkallën e rëndësisë së saj.

120. Prandaj, është e domosdoshme të verifikohet që masa e sanksionit është në përpjesëtim me ashpërsinë e shkeljes dhe me përmasat e ndërmarrjes së cilës i përket subjekti që ka kryer shkeljen, si dhe që sanksioni i vendosur në këtë mënyrë nuk duhet të tejkalojë çfarë është e nevojshme/domosdoshme për të arritur objektivat e ndjekur nga dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

121. Si një derivat i veçantë i parimit të proporcionalitetit, Zyra e Komisionerit mund të konsiderojë të zvogëlojë më tej masën e sanksionit në bazë të paaftësisë së kontrolluesit/përpunuesit për të paguar. Çdo zvogëlim i tillë kërkon rrethana të jashtëzakonshme. Kësisoj, duhet të ketë prova objektive që vendosja e sanksionit do të rrezikonte në mënyrë të pakthyeshme qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fjalë. Për më tepër, rreziqet duhet të analizohen në një kontekst specifik social dhe ekonomik.

a) **Qëndrueshmëria ekonomike:** ndërmarrja duhet të paraqesë të dhëna të detajuara financiare



(për pesë vitet e fundit, si dhe projeksione për vitin aktual dhe dy vite të ardhshme) me qëllim që Zyra e Komisionerit të shqyrtojë zhvillimin e mundshëm në të ardhmen të faktorëve kyç si aftësia paguese, likuiditetit dhe rentabiliteti. Rrethanat e thjeshta që një ndërmarrje është në një situatë të keqe financiare, ose do të jetë pas një mase të madhe sanksioni, nuk e plotëson kërkesën në fjalë, pasi njohja e një detyrimi të tillë do të ishte e njëjtë me dhënien e një avantazhi konkurrues të pajustificuar për ndërmarrjet më pak të përshtatura me kushtet e tregut³³.

b) **Vërtetimi i humbjes së vlerës:** masa e sanksionit mund të zbritet vetëm nëse vendosja e saj do të rrezikonte qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes dhe do të shkaktonte që asetet/aktivet e saj të humbnin të gjithë ose pjesën më të madhe të vlerës së tyre. Duhet të tregohet një lidhje e drejtpërdrejtë shkakësore midis sanksionit dhe humbjes së konsiderueshme të vlerës së aseteve/aktiveve. Për më tepër, nuk mund të shtrohet për diskutim që masa e sanksionit të ketë kërcënuar qëndrueshmërinë ekonomike të një ndërmarrjeje, kur kjo e fundit kishte vendosur vetë të likujdojë veprimtarinë e saj dhe të shesë të gjitha asetet/aktivet e saj. Ndërmarrja duhet të provojë se ka të ngjarë të dalë nga tregu dhe asetet/aktivet e saj do të copëtohen ose shiten me çmime konsiderueshëm të ulta, pa alternativë për ndërmarrjen (ose asetet/aktivet e saj) të vazhdojnë operimin në treg.

c) **Konteksti specifik social dhe ekonomik:** konteksti specifik ekonomik mund të konsiderohet nëse sektori në fjalë po kalon një krizë ciklike (p.sh., vuan nga stoku (*overcapacity*) ose rënia e çmimeve) ose nëse ndërmarrjet kanë vështirësi aksesit në kapital ose kredi, si rezultat i kushteve mbizotëruese ekonomike. Konteksti specifik social ka të ngjarë të jetë i pranishëm në kontekstin e papunësisë së lartë nivel rajonal ose më gjerë.

122. Nëse kriteret plotësohen, Zyra e Komisionerit mund të marrë parasysh paaftësinë e ndërmarrjes për të paguar sanksionin dhe të zvogëlojë masën e tij në përputhje me rrethanat.

7.3 Karakteri parandalues

123. Së fundmi, një sanksion me karakter parandalues është ai që ka një efekt të vërtetë

frenues. Në këtë aspekt, mund të bëhet një dallim midis frenimit të përgjithshëm (dekurajimit të të tjerëve që të kryejnë të njëjtën shkelje në të ardhmen) dhe frenimit specifik (dekurajimit të shkelësit që të kryejë përsëri të njëjtën shkelje).

124. Një sanksion është me karakter parandalues kur frenon një individ që të shkelë objektivat e ndjekur, si dhe rregullat e përcaktuara, nga dispozitat e ligjit. Vendimtare, në këtë kuadër, nuk është vetëm natyra dhe masa e sanksionit, por edhe mundësia e vendosjes së tij. Kushdo që kryen një shkelje duhet të kuptojë se sanksioni do t'i vendoset vërtet.

KAPITULLI 8

FLEKSIBILITETI DHE VLERËSIMI I RREGULLT

125. Kapitujt e mësipërm pasqyrojnë një metodologji të përgjithshme për përlogaritjen e masave të sanksioneve. Megjithatë, kjo metodologji e përgjithshme nuk duhet të keqkuptohet si një formë përlogaritjeje automatike, ose aritmetike, e masës së sanksionit. Caktimi individual i sanksionit duhet të bazohet gjithmonë në vlerësimin njerëzor të të gjitha rrethanave përkatëse të çështjes dhe duhet të jetë efektiv, proporcional dhe me karakter parandalues në lidhje me atë çështje specifike.

126. Duhet mbajtur parasysh se kjo metodologji nuk mund të parashikojë çdo veçori të mundshme të një rasti shkeljeje dhe për rrjedhojë nuk mund të jetë shteruese. Rrjedhimisht, kjo metodologji i nënshtrohet rishikimit të rregullt për të vlerësuar nëse zbatimi i saj përmbush efektivisht objektivat e kërkuar nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Komisionerit mund ta rishikojë këtë metodologji bazuar në përvojat e mëtejshme të saj në zbatimin praktik të përditshëm të ligjit, si dhe bazuar në praktikën e ndjekur nga autoritetet mbikëqyrëse të BE-së dhe, veçanërisht, BEMD-ja. Zyra e Komisionerit mund të shfuqizojë, ndryshojë, kufizojë ose zëvendësojë këtë metodologji në çdo kohë të caktuar, me efekt për të ardhmen.

³³ Shih jurisprudencën e BE-së, ndër të tjera, në çështjet e përbashkëta (*joined cases*) C-189/02 P, C-202/02 P, C-

205/02 P deri C-208/02 P dhe C-213/02 P, *Dansk Rørindustri dhe të tjerët kundër Komisionit*.

**VENDIM****Nr. 433, datë 22.7.2025****PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE
STANDARDE MINIMALE KOHORE
DHE STANDARDEVE MINIMALE
SASIORE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës, nenit 94, pika 4, shkronjat “a” dhe “h”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 2, shkronja “m”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të anëtarëve znj. Irena Plaku, z. Ridvan Hado dhe z. Markelian Koça,

VENDOSI:**I****Parime të përgjithshme**

1. Përcaktimi i rregullave për afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasiore të gjykimit të çështjeve me qëllim rritjen e efikasitetit të gjykatave bazohet në parimet e mirëqeverisjes, efektivitetit, transparencës dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, duke synuar standarde të njëjta për të gjithë gjyqtarët, ngarkesë të ekuilibruar të punës në gjykata dhe rritjen e besimit të publikut në gjyqësor.

2. Afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasiore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore në këtë vendim janë orientuese dhe përcaktohen me qëllim rritjen e efektivitetit të gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të shkallës së parë dhe të apelit.

3. Afatet standarde minimale kohore zbatohen vetëm për ato çështje për të cilat ligji nuk parashikon afate gjykimi.

4. Standardi minimal kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor minimal, nga data e caktimit të gjyqarit të çështjes. Për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm afati

minimal kohor, fillon nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

5. Standardi minimal sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale përcaktuar në këtë vendim.

6. Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, me qëllim rritjen e efektivitetit, miradministrimin gjyqësor dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë, mund të përcaktojë standarde të tjera kohore dhe sasiore duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve.

II**Afatet standarde minimale kohore në
gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të
përgjithshëm**

1. Afatet standarde minimale kohore në seksionin penal të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë si më poshtë:

- a) kërkesat penale jo më gjatë se 2 muaj;
- b) kundërvajtjet penale, jo më gjatë se 2 muaj;
- c) çështjet penale, për të cilat ligji parashikon dënimin deri në 10 vjet, jo më gjatë se 9 muaj;
- d) çështjet penale, për të cilat ligji parashikon dënimin mbi 10 vjet apo me burgim të përjetshëm, jo më gjatë se 12 muaj.

2. Afatet standarde minimale kohore në seksionin civil të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë si më poshtë:

- a) kërkesat civile me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, jo më gjatë se 1 muaj;
- b) çështjet civile pa palë kundërshtare, jo më gjatë se 2 muaj;
- c) çështjet civile me objekt marrëdhënie pune, jo më gjatë se 4 muaj;
- ç) çështjet tregtare dhe familjare pa palë kundërshtare, jo më gjatë se 4 muaj;
- d) çështjet civile, tregtare dhe familjare me palë kundërshtare, jo më gjatë se 6 muaj;
- dh) çështjet civile themeli me palë kundërshtare të natyrës komplekse, jo më gjatë se 12 muaj.



III

Afatet standarde minimale kohore në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ

Afatet standarde minimale kohore në gjykatat administrative të shkallës së parë janë si më poshtë:

- a) kërkesat administrative me objekt lëshimin e urdhrit ekzekutimi, jo më gjatë se 1 muaj;
- b) kërkesat administrative pa palë kundërshtare, jo më gjatë se 2 muaj;
- c) çështjet administrative me palë kundërshtare, jo më gjatë se 6 muaj.

IV

Afatet standarde minimale kohore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

1. Afatet standarde minimale kohore në seksionin penal në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë si më poshtë:

- a) kundërvajtjet penale, jo më gjatë se 2 muaj;
- b) kërkesat penale, jo më gjatë se 3 muaj;
- c) çështjet penale themeli, jo më gjatë se 6 muaj.

2. Afatet standarde minimale kohore në seksionin civil në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë si më poshtë:

- a) kërkesat civile me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, jo më gjatë se 2 muaj;
- b) kërkesat civile pa palë kundërshtare, jo më gjatë se 2 muaj;
- c) çështjet civile me objekt marrëdhënie pune, jo më gjatë se 4 muaj;
- ç) çështjet familjare, jo më gjatë se 4 muaj;
- d) çështjet civile dhe tregtare me palë kundërshtare, jo më gjatë se 6 muaj;
- dh) çështjet civile me palë kundërshtare, të natyrës komplekse, jo më gjatë se 12 muaj.

V

Afatet standarde minimale kohore në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar

1. Afatet standarde minimale kohore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë si më poshtë:

- a) kërkesat penale, jo më gjatë se 4 muaj.
- b) çështjet penale, për të cilat ligji parashikon dënimin deri në 10 vjet, jo më gjatë se 9 muaj;
- c) çështjet penale, për të cilat ligji parashikon dënimin mbi 10 vjet apo me burgim të përjetshëm, jo më gjatë se 12 muaj.

2. Afatet standarde minimale kohore në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë si më poshtë:

- a) kërkesat penale, jo më gjatë se 4 muaj;
- b) çështjet penale me palë kundërshtare, jo më gjatë se 6 muaj.

VI

Standardet minimale sasiore

1. Standardet minimale sasiore janë si më poshtë:

a) gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si relator, gjykon jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare dhe jo më pak se 200 çështje pa palë kundërshtare;

b) gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit administrativ, si relator, gjykon jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare dhe jo më pak se 150 çështje pa palë kundërshtare;

c) gjyqtari i gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, si relator, gjykon jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare;

ç) gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si relator gjykon jo më pak se 20 çështje me palë kundërshtare;

d) gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si relator gjykon jo më pak se 20 çështje me palë kundërshtare.

VII

Monitorimi i zbatimit të afateve minimale standarde kohore dhe standardeve minimale sasiore

1. Kryetarët e gjykatave monitorojnë zbatimin e afateve minimale standarde kohore dhe standardeve minimale sasiore çdo tre muaj dhe



përcjellin raportin përkatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Në rast se gjyqtari nuk arrin të realizojë këto standarde, sipas këtij vendimi, atëherë raporton pranë Kryetarit të Gjykatës për arsyet e mosrealizimit të tyre dhe masat që do të ndërmarre për t'i realizuar ato duke përcaktuar dhe nevojën për mbështetje me burime njerëzore shtesë nga ana e gjykatës me qëllim përmbushjen e tyre. Raporti i gjyqtarit përfshihet në raportimin e gjykatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

KËRKESË

Shtetasja Valbona Elqeni (Deda) kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Deda, me atësi Ali dhe me amësi Aishe, i datëlindjes 13.3.1981.

KËRKUESE
Valbona Elqeni (Deda)

KËRKESË

Shtetasi Ervin Bici kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, shpalljen të vdekur më datë 9 mars 1996 të shtetasit Mehmet Bici, i datëlindjes 8.2.1956, lindur në Burim, Dibër dhe banues në Bulqizë.

KËRKUES
Ervin Bici

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

